



Vlerësimi tematik i ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

**Monitorimi pilot i këshillit bashkiak
Tiranë - Kamëz - Vorë
2016-2017**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Albania



INFOÇIP

Qendra për Çështjet e Informimit Publik



Nëntor, 2017

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Copyright: Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP

Materiali që përmban ky publikim nuk mund të kopjohet apo riprodhohet në asnjë rrethane.

Te dhenat që përmban ky raport mundet vetëm

të citohet me kusht që të njihet/citohet autorësia e tij përmes referimit të plotë në tekst të attributeve të autorit

Një kopje e publikimit që përmban materialin e referuar duhet t'i dërgohet INFOÇIP.

Çdo përdorim i parashtrimeve teorike apo i gjetjeve që përmban ky studim, pa leje dhe/ose nga të tretë është i ndaluar dhe subjekt penalizimi nga legjislacioni në fuqi për të drejtën e autorit

Drejtor i research-it & autor i metodës:

Gerti Shella

Eksperte dhe Staf i përfshirë në studim

Petri Dollani

Ymer Hoxha

Donaltina Vila

Dritjon Selmani

Altea Krajka

Diart Nezaj

Egest Xhoga

Mbështetur nga Ambasada Zviceriane Tiranë dhe Lëviz Albania



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Embassy of Switzerland in Albania



Realizuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP



Hyrje

Mbi monitorimin e INFOÇIP, mbështetur nga Lëviz Albania

Në fokus të këtij monitorimi tematik, i cili realizohet për herë të parë bazuar në legjitimitetin që cakton ligji ri 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", është transparenca me publikun dhe funksioni vendimarrës i këshillit bashkiak. Administrata e Bashkisë, si një organ i centralizuar monokratik, që drejtohet nga kryetari i bashkisë, nuk është objekt i drejtpërdrejtë monitorimi/vlerësimi.

INFOÇIP ka përllogaritur nivelin e zbatueshmërisë të dispozitave që përman Kreu VI "Transparenca, Konsultimi dhe Pjesëmarrja qytetare" i ligjit 139/2015. Pilotimi i këtij vlerësimi të parë tematik është bërë në bashkitë Tiranë Kamëz dhe Vorë. Të treja bashkitë kanë tipologji të ndryshme si në terma të popullatës ashtu edhe të konfigurimit politik. Ato janë të treja pjesë e Qarkut Tiranë. Nenet 15-20 që përmban Kreu VI janë vlerësuar të gjitha, përmes metodës PROAKTIV (shih metodologjia) duke identifikuar të dispozitat dhe indikatorët e kuantifikueshëm. Rezultatet e përllogaritjes së nivelit të zbatueshmërisë së dispozitave të Kreut VI vizualizohen grafikisht për të treja bashkitë.

Në kuadër të këtij studimi, INFOÇIP ka bërë dhe një vlerësim të dytë tematik lidhur me procesin vendimarrës të realizuar në periudhën nëntor 2016-Nëntor 2017. Konkretisht, objekt vlerësimi në këtë ushtrim kompleks janë modalitetet *e diskutimit paraprak* (me publikun), *votimit*, *shpalljes* dhe *hyrjes në fuqi* të vendimeve të Këshillit Bashkiak. Pjesa dërmuese e dispozitave që mat ky vlerësim i dytë gjenden në Kreun IX të ligjit 139/2015. Të gjitha nenet në këtë Kre janë vlerësuar përmes teknikës së analizës ligjore, duke kontrastuar të dhënat e sjella nga terreni me parashikimet ligjore në fuqi. Zbatimi i dispozitave që përmbajnë nenet e Kreut IX është gjithashtu kusht juridik për të garantuar vendimarrje transparente, pjesëmarrje të publikut në procesin vendimarrës si dhe akses të publikut në legjislacionin vendor (*njohje efektive me aktet e Këshillit Bashkiak*).

Identifikimi dhe veçimi paraprak i dispozitave që përmbajnë nenet në fjalë, me synim matjen e tyre realizohet për herë të parë. Ajo mbart limite, por ka potencial të lartë për t'u zhvilluar më tej nga aktorë të tjerë të interesuar në përllogaritjen objektive të zbatimit të ligjeve apo dispozitave të veçanta që janë objekt i punës së tyre në nivel të qeverisjes vendore. Metoda "copton" nenet në paragrafë, pastaj identifikon paragrafët e matshëm të cilët i "thyen" në dispozita (urdhërime konkrete singulare). Me tej dispozitat "përthyen" në indikatorë të matshëm. Paragrafët që afirmojnë parime nuk maten në kuadër të Metodës PROAKTIV. Rezultatet e matjes për çdo nivel, agregohen në përqindje për të dhënë në finale një shumatore që synon të ofrojë një vlerë në përqindje të nivelit të zbatimit të nenet që është marrë nën vlerësim. Metoda e përdorur synon të gjenerojë të dhëna për zbatimin e ligjit (në dy blloqet tematike të përzgjedhura) dhe jo domosdoshmërisht për nivelin e zbatueshmërisë së ligjit nga këshillat bashkiakë veç e veç, edhe pse kjo nuk përjashtohet për nga vetë lloji i matjes.

Baza ligjore

Parime kushtetuese

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore (*Neni 13 i Kushtetutës*). Organet përfaqësuese të njësive bazë të qeverisjes vendore janë këshillat, të cilat zgjidhen çdo katër vjet me zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë¹. Organi ekzekutiv i bashkisë ose i komunës është kryetari, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga populli. Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendore dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse². Njësitë e qeverisjes vendore janë persona juridikë dhe kanë buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj³.

Kushtetuta prioritarizon funksionin vendimarrës të këshillit (organ kolegjal) krahasuar me funksionet ekzekutive të kryetarit të bashkisë. Në nenin 113 të saj ajo përcakton se këshillat rregullojnë dhe administrojnë në mënyrë të pavarur çështjet vendore brenda juridiksionit të tyre; ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike. Po ashtu këshillat kanë të drejtë të mbledhin dhe të shpenzojnë të ardhurat që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve të tyre si dhe të vendosin taksat vendore dhe nivelin e tyre. Kushtetuta gjithashtu parashikon se këshillat caktojnë rregullat për organizimin dhe funksionimin e tyre, krijojnë simbolet e qeverisjes vendore, si dhe titujt vendore të nderit⁴.

Organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra⁵. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe (*neni 116 i Kushtetutës*). Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj (*Neni 120 i Kushtetutës*).

Ligji organik për Pushtetin Vendor.

Në Dhjetor 2015, Kuvendi miratoi ligjin e ri 139/2015 "Për Vetë-qeverisjen Vendore", i cili hyri në fuqi më 29 Janar 2016, duke shënuar një moment kulmor që hap rrugën forcimit të demokracisë vendore pas RAT dhe thellimit të decentralizimit. Për herë të parë, një kapitull i plotë (Kreu VI) i këtij ligji i dedikohet tërësisht transparencës dhe të drejtave të qytetarëve në vendimarrje.

Në relacionin shpjegues që shoqëroi projektligjin në Kuvend, ky kre' konsiderohej një risi⁶. Në kohën e hartimit të këtij ligji kuadër shumë të rëndësishëm, Kuvendi kishte miratuar që më parë Ligjin Nr. 119/2014 "Per të drejtën e informimit" dhe Ligjin Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik". Ligji 139/2015 referon direkt ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", për sa i takon transparencës së veprimtarisë dhe publikimit të vendimeve/akteve të tjera të bashkisë (*neni 15, 18/3*)⁷.

1. Neni 109, *Ndryshuar pika 1 me ligjin nr.9675, datë 13.1.2007*.

2. Po aty

3. Neni 111 i Kushtetutës

4. Neni 113, paragrafi I, Kushtetuta e Shqipërisë, e ndryshuar.

5. Po aty

6. "Projektligji gjithashtu sjell një risi normative në kuadrin e ndërtimit të marrëdhënieve të transparencës dhe të drejtës për pjesëmarrje të qytetarëve në vendimarrjen e organeve vendore". Fq. 2, link "https://www.parlament.al/ep-content/uploads/2015/11/relacion_veteqeverisja_vendore.pdf"

7. Në terma të metodologjisë së hartuar nga INFOCIP, niveli i implemetimit të neneve 15 dhe 18/3 të ligjit 139/2015 është ekuivalent me nivelin e impementimit të blloqeve mundësuese të ligjit 119/2014 dhe për këtë do të përdoret metodologjia e dizenuar nga INFOCIP për këtë qëllim. Shih: <http://www.infocip.org/al/ep-content/uploads/2017/10/Raporti-implementimi-i-ligjit-119-nga-61->

si dhe transpozon parimet e ligjit 146/2014 në nënin 16. Ky i fundit në fakt do të duhej të ishte i pashkëputur nga neni 18 "Seancat e këshillit me bashkësinë", pasi në thelb kërkesat për konsultim publik aplikohen pikërisht mbi vendimarrjen e këshillit, dhe ku një pjesë e kësaj vendimarrje nuk është ligjore nëse nuk konsultohet më parë. Veçimi në dy nene të ndryshme nga ligjvënësi i detyrimit për konsultim publik, në rastin më të mirë nuk përben "ekonomi" në terma të teknikës legjislative të përdorur. Në rastin më të keq, ajo krijon vështirësi në matjen e implementimit të ligjit, në rastin konkret të kreut VI të ligjit 139/2015.

Në kushte të tjera, do të kishte qënë gjithsesi më e pranueshme që neni 18 të renditej direkt pas nenit 16 sepse është pikërisht neni 18 që normon atë që në kuadër të vlerësimeve të INFOÇIP përfaqëson fazën paraprake të vendimarrjes, në të cilën këshilli bashkiak harmonizon vendimarrjen e vet me grupet e interesuara. Ai ka madje një lidhje direkte edhe me nënin 54 të ligjit 139/2015. Madje, paragrafi 3 i nenit 19 lidhet organikisht me përcaktimet që përmban neni 55, paragrafi 6. Nenet 54 dhe 55 janë të renditura në kreun IX të ligjit 139/2015⁸ (shih më poshtë shpjegimet për nënin 18)

Neni 17, pikërisht ai që ka të bëjë me mbledhjet e hapura do të duhet të vinte jo para, por pas nenit 18, pasi ai normon pikërisht momentin kur konsultimi ka përfunduar dhe tashmë vendimarrja hyn në proces të rregull legjislativ në këshill. Neni 17 "Mbledhjet e Hapura" implikon pikërisht procesin final, pra diskutimin dhe votimin në seancë plenare, dhe jo konsultimet paraprake. Neni 17 është një transpozim thuajse i drejtpërdrejtë i parimeve kushtetuese që përmbahen në nënin 23, paragrafi 3 sipas të cilit: *Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive*⁹.

Për t'u rikthyer edhe njëherë tek neni 18 "Seancat e këshillimeve me bashkësinë", është me rëndësi të theksohet se këshillimi është i detyrueshëm për këshillin bashkiak përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve kur:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;

Nga pikpamja procedural, këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

[bashkite-e-RSH.pdf](#)

8. KREU IX PËRBËRJA, KRIJIMI, MËNYRA E ORGANIZIMIT, KOMPETENCAT DHE DETYRAT E KËSHILLIT BASHKIAK

9. E drejta e pjesëmarrjes dhe informimit përfshihen në kreun "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", në Kushtetutën e Shqipërisë⁶. Neni 23 i saj përcakton shprehimisht se: 1) E drejta e informimit është e garantuar; 2) Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore; 3) Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Një risi' e ligjit 139/2015 u konsiderua edhe përfshirja e një dispozite të vetme për realizimin e referendumeve vendore, konkretisht tek neni 18 "*Seancat e këshillimit me bashkësinë*". Neni në fjalë, siç kuptohet më sipër, përmban parimet e konsultimit parakrak të vendimarrjes, si në rastet e buxhetit, taksave dhe tarifave, tjetërsimit të pronës publike etj. Në fakt, procesi referendar në përgjithësi nuk ligjetimohet nga Kushtetuta e Shqipërisë për çështje të tilla apo vendimarrje të këtij karakteri. Thënë kjo, e drejta për referendum vendor, pavarësisht se është përfshirë në kapitullin VI të ligjit 139/2015 është e pa-realizueshme në kontekstin aktual, për arsye që lidhen me mungesën e një ligji kuadër material dhe procedural që do të normonte procesin referendar në nivel vendor dhe madje edhe qëndror. Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 108, paragrafi 4 i saj përcakton shprehimisht se: "**Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2**". Sikurse u përmend më sipër, Shqipëria ende nuk ka miratuar një ligj kuadër për referendume në nivel qëndror dhe vendor. Edhe vetë ligji 139/2015 nuk ofron asgjë në këtë drejtim duke u vet-limituar në transpozimin e një garancie kushtetuese, por duke mos ofruar asnjë më shumë se kaq në drejtim të aktivizimit të kësaj të drejte themelore në nivel të qeverisjes vendore. Për këtë arsye, dispozita përkatëse në nenin 18 është e pamatshme në kuadër të metodologjisë së përgatitur nga INFOÇIP për vlerësimin e implementimit të kapitullit VI të ligjit të 139/2015.

Vlen të theksohet në këtë kontekst se ligji 139/2015 mbart një paradoks të pazakonte. Ai nuk është i harmonizuar me Kushtetutën e Shqipërisë. Në fakt, pohimi korrekt do të duhej të ishte se vetë Kushtetuta nuk është në harmoni me ligjin 139/2015, pasi në nenin 108 të saj, Kushtetuta vijon të referojë konceptin "komunë". Konkretisht, në paragrafin 1 dhe 3 të nenit 108 shkruhet shprehimisht:

- 1. Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet. Njësi të tjera të qeverisjes vendore rregullohen me ligj.*
- 2. Komuna dhe bashkia janë njësi bazë të qeverisjes vendore. Ato kryejnë të gjitha detyrat vetëqeverisese, me përjashtim të atyre që me ligj u jepen njësite të tjera të qeverisjes vendore.*

Edhe pse Kushtetuta e Shqipërisë iu nënshtrua ndryshimeve të thella në vitin 2015¹⁰ dhe në vitin 2016¹¹, dhe ndonëse koncepti "komunë" ishte eliminuar që në vitin 2014 me ligjin Nr. 115/2014 "*Përndarjen administrativo-territoriale të njësite të qeverisjes vendore në RSH*", ligjvënësi e la pas dorë reflektimin në Kushtetutë të këtyre ndryshimeve të rëndësishme. Nëse dikush sot do të atakonte në Gjykatë Kushtetuese ligjin 115/2014 apo edhe ligjin 139/2015, me gjasë GJK mund ta gjentë atë jo në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

Ligji 139/2015 njeh dhe përshkruan në kapitullin VI të tij të drejtën e "iniciativës qytetare" për të propozuar projekt-akte të caktuara për vendimarrje nga këshillat bashkiakë. Mbi bazën e kësaj të drejte, projekt-aktet që vijnë si iniciativë qytetare do të duhet domosdoshmërisht të futen në procesin e shqyrtimit e të miratimit nga ana e këshillave bashkiakë. Sipas dispozitave të nenit 20, çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.

10. ndryshuar me ligjin nr.137/2015, datë 17.12.2015

11. ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016

Pavarësisht kësaj garancie ligjore, kuadri ligjor mbështetës apo mundësues është i mangët për të mos thënë in-ekzistent në Shqipëri. Kushtetuta parashikon vetëm rastin e nismës ligjore në nivel qendror, por jo edhe në atë vendor. Neni 81 i Kushtetutës, që rregullon procesin ligjvënës, e orienton demokracinë e drejtpërdrejtë vetëm në procesin legjislativ propozues kur parashikon se *"të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës"*. Pavarësisht se akti themeltar afirmon në nenin 2 të tij parimin e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit, ku përfshihet nisma ligjore qytetare dhe referendumi, detajimi i këtij procesi ka ngelur i parealizuar që nga miratimi i Kushtetutës në vitin 1998.

Ligji 139/2015 i ka lënë diskrecion këshillave bashkiakë të parashikojnë në rregulloren e funksionimit të tyre normat e zhvillimit të këtij procesi. Në kuadër të këtij vlerësimi kjo konsiderohet një mangësi e rëndësishme e ligjit 139/2015 pasi normimi i këtij procesi duhet të burojë pikërisht prej vetë ligjit organik. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të matej një proces i tillë përmes një metodologjie të unifikuar. Për më tepër, rregulloret e këshillave, për nga vetë natyra e tyre tentojnë të jenë të larmishme si në formulime ashtu edhe në koherencë ligjore. Sa për ilustrim, Këshilli Bashkiak Tiranë vijon akoma të funksionojë me një rregullore të para vitit 2015, e cila vijon të referojë ligjin e vjetër Nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"¹².

Ligji 139/2015 krijon kushte ligjore për funksionimin e strukturave komunitare në qytete, në formën e këshillave komunitarë të lagjeve dhe mekanizmin e ndërlidhësit komunitar, duke plotësuar kështu një vakum që kishte në hapësirën urbane në raport me fshatin. Megjithatë, dy vjet pas miratimit të këtij ligji, janë hasur vështirësi të mëdha në praktikë sa I takon formimit të këtyre strukturave e mandaj sigurisht aktivizimit të tyre. Megjithatë, ky raport nuk ka në fokusin e vet të vlerësimit këtë aspekt.

Sipas relacionit për projektligjin:

Kreu VI përcakton dispozitat në lidhje me detyrimin për të garantuar transparencën, të drejtën e informimit dhe të drejtën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen e organeve të qeverisjes vendore. Në nenin 15, e drejta e transparencës garantohet nëpërmjet detyrimit të publikimit të çdo akti në faqen zyrtare të internetit dhe të afishuara në vendet e caktuara për njoftimet publike. E drejta e konsultimit e përcaktuar në nenin 16 detyron njësitë e qeverisjes vendore të përmbushin të gjitha detyrimet që vijnë nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Neni 17 dhe 18 e garanton më tej të drejtën e pjesëmarrjes qytetare duke përcaktuar që mbledhjet e këshillave janë të hapura kudoherë dhe se seancat e këshillimit janë të detyrueshme në disa raste specifike siç është hartimi i buxhetit vendor. Neni 19 jep të drejtën qytetarëve për t'u përcjellë organeve vendore, kërkesa, ankesa dhe vërejtje, si një e drejtë demokratike e qytetarëve për të shprehur kudoherë shqetësimet e tyre para organeve përkatëse të qeverisjes vendore. Neni 20 përcakton të drejtën e qytetarëve për të propozuar marrjen e vendimmarrjes përkatëse nëpërmjet iniciativës qytetare. Kjo e drejtë materializon në praktikë përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrjen publike dhe influencimin e kësaj vendimmarrje.

Kreu IX i ligjit sanksionon në detaje dispozitat e organizimit dhe kompetencave të këshillit bashkiak. Neni 45 dhe 46 përcakton mënyrën e zgjedhjes dhe numrin e anëtarëve të këshillave bashkiakë. Neni 47 përcakton papajtueshmëritë e funksionit të këshilltarit bashkiak. Neni 48 përcakton rregullat e organizimit të mbledhjes së parë të këshillit bashkiak të dalë nga zgjedhjet vendore. Neni 49 përcakton rregullat për dhënien dhe heqjen e mandatit të këshilltarit bashkiak. Neni 50 përcakton formulën e betimit. Neni 51 përcakton të drejtat e këshilltarëve në ushtrimin e mandatit. Neni 52 përcakton dispozitat për ndalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e mandatit të këshilltarit. Neni 53 përcakton rregullat e përgjithshme të funksionimit të këshillit bashkiak. Neni 54 përcakton detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak. Neni 55 përcakton rregullat e votimit në këshill dhe shumicën e kërkuar për votimin në çështje të caktuara. Neni 56 përcakton rregullat e zgjedhjes dhe shkarkimit të kryetarit të këshillit bashkiak dhe zëvendëskryetarëve, si dhe detyrat e tij. Neni 57 përcakton rregullat e emërimit dhe shkarkimit të sekretarit të këshillit bashkiak dhe detyrat e tij. Neni 58 përcakton rregullat e shpërndarjes së parakohshme të këshillit bashkiak.

12. <http://www.tirana.al/keshilli-bashkiak/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/>

Çfarë është një vendimarrje e hapur dhe transparente?

Procesi vendimarrës në nivel vendor kalon nëpër tre faza të dallueshme qartësisht:

- 1) *draftimi dhe hartimi i projekt-vendimeve;*
- 2) *votimi në seancë plenare;*
- 3) *hyrja në fuqi e vendimeve dhe njoftimi i tyre subjekteve.*

Një vendimarrje e hapur dhe transparente do të duhej të reflektonte parashikimet ligjore në fuqi për të treja etapat nëpër të cilat ajo kalon. Në kushte ideale, vendimarrja do të duhej t'i nënshtrohej paraprakisht konsultimit dhe harmonizimit të projekt-vendimit me aktorët e interesit dhe publikun, ku këshilli bashkiak (vendimarrësi) përmbush funksionin ligjor të intelokutorit. Po ashtu, që një vendimarrje të ishte e hapur dhe transparente do të duhej që në procesin e vendimarrjes në seancë plenare, garancitë kushtetuese dhe ligjore për mbledhje të hapura ku *secilit i krijohet mundësi efektive të marrë pjesë* të përmbushen efektivisht. Po ashtu, kërkesat ligjore për njoftimin paraprak të mbledhjes, axhendës, por edhe garantimi i kuorumit vendimarrës dhe mbajtja e procesverbalit të mbledhjes duhet të respektohen rigorozisht që procesi të konsiderohet i hapur, në kuptim ligjor të këtij termi. Së fundmi, aktet e miratuara duhet të kalojnë në një proces verifikimi të ligjshmërisë së tyre nga një organ i pavarur. Të tilla organe janë Prefekti (organ monokratik dhe me varësi direkte nga dega ekzekutive e pushtetit qëndror) dhe gjykata administrative (degë e veçantë e pushtetit gjyqësor që ka objekt zgjidhjen e mosmarrjeveshjeve me natyrë administrative).

Pas zbardhjes, vendimet duhet të shpallen publikisht apo t'i njoftohen subjekteve që ato adresojnë, duke respektuar aftet ligjore në fuqi. Aktet normative të cilat nuk shpallen përmes publikimit apo njoftimit, nuk mund të marrin fuqi ligjore në territorin që ka nën juridiksion bashkia. Po ashtu, aktet individuale të cilat nuk i njoftohen subjekteve që ato adresojnë, janë *nul* juridikisht dhe futja e tyre në fuqi të njëanshme do ishte një tregues i keq-qeverisjes dhe mungesës së transparencës. Njoftimi efektiv i vendimarrjes është shërbim bazik i qeverisjes, pasi askujt nuk i lind detyrimi ligjor për zbatimin e urdhërimeve juridike nëse ai/ajo nuk merr më parë njoftim për to.

Konsultimi

Në fazën e parë të procesit vendimarrës në nivel vendor, ligji 139/2015 i ka dhënë rëndësi të posaçme konsultimit të projekt-akteve me aktorët e interesit dhe me publikun. Seancat e këshillimeve me komunitetin janë të detyrueshme për këshillin bashkiak *përpara shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit dhe ndryshimeve të tij, kur vendos për taksat dhe tarifa vendore akteve, kur miraton tjetërsimin e pronave dhe/ose dhënie në përdorim të të tretëve*. Gjithashtu konsultimi publik është një detyrim ligjor kur Këshilli zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet, kur miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimit të interesit publik (nei 18, paragrafi 1).

Një tjetër vendimarrje e rëndësishme e këshillave bashkiakë e cila duhet të kalojë në fazat e konsultimit është ajo që ka të bëjë me planet rregulluese vendore. Në këtë rast, kërkesa për konsultim buron nga kuadri ligjor për urbanistikën. Në ligjin 139/2015, kjo normative nuk është e harmonizuar në mënyrë eksplicite edhe pse mund të derivohet apo deduktohet nga parashikimet që përmbajnë neni 18, paragrafi 1 dhe neni 54, germa "e". Megjithatë, për fuqinë normuese që duhet të përmbaje një ligj kuadër, material dhe procedural, sic është ligji "Për vetë qeverisjen vendore", parashikimet që ai

përmban për çështjen e zhvillimit dhe kontrollit të territorit janë minimaliste në terma të konsultimit me publikun.

Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jo-fitimprurëse, etj.

Sipas përcaktimeve të nenit 16 të ligjit 139/2015, Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimarrjes. Ligji organik megjathtë nuk detajon asnjë procedurë dhe as nuk cakton apo referon organ mbikqyrës apo zbatues për të garantuar plotësimin e detyrimit që i ngarkohet organit vendor për të ndërmarrë konsultime. As në praktikë, konsultimi i vendimarrjes nuk verifikohet si reflektim i një detyrim ligjor që rëndon mbi organin vendimarrës, por gjithmonë e më shpesh si një apel i aktorëve të shoqërisë civile ndaj vendimarrësve vendore të cilët, në fare pak raste e "marrin mundimin". Për fat të keq, edhe pse janë sinjalizuar herë pas herë zyrtarisht nga aktorë të specializuar të shoqërisë civile, edhe Prefektët, të cilat kanë funksion parësor ligjor garantimin e ligjshmërisë së proceseve vendimarrëse, kanë mbyllur sytë para kësaj praktike.

Një tjetër "keqkuptim" i rëndësishëm me procesin konsultativ në nivel të vendimarrjes vendore janë proceset e buxhetimit me pjesëmarrje të cilat udhëhiqen fillim-mbarim nga kryetari i bashkisë dhe stafet ekzekutive në varësi të tij.

Në asnjë nen të vetëm të ligjit 139/2015, kryetari i bashkisë nuk ka funksion ligjor organizimin e konsultimeve, as për buxhetin, as për taksat dhe as për tipologji të tjera vendimarrjesh të cilat kalojnë në procese konsultative. Madje ligji 139/2015 praktikisht e ndalon kryetarin e bashkisë të ndërmarrë konsultime. Në nenin 64¹³ të ligjit, paragrafi "a" përcaktohet shprehimisht se kryetari i bashkisë ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës. Nëse shohim kompetencat e këshillit në nenin 54, bëhet e qartë se rastet e vendimarrjeve që kërkojnë konsultim (germat "a", "dh", "e", "f" dhe "k"), janë kompetenca klasike të këshillit dhe si të tilla ato nuk mund të ushtrohen nga kryetari i bashkisë. Praktika ekstra-ligjore kur kryetari i bashkisë që ndërmer nismën ligjore në nivel vendor bën njëkohësisht edhe konsultimin e saj, janë një deformim ose keqinterpretim i normativës ligjore në

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak; miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijojnë vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- h) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;
- l) vendos për simbolet e bashkisë;
- ll) vendos për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë;
- m) jep tituj nderi dhe stimuj;
- n) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe për zbatim të ligjit, me të cilin bëhet ky delegim te bashkia.

13. Neni 64 Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

fuqi dhe për këtë arsye nuk meritojnë të inkurajohen. Promovimi i tyre, në rastin më të mirë është një anashkalim i kërkesave eksplicite ligjore dhe në rastin më të keq një shkelje e dispozitave dhe frymës së ligjit 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore".

I vetmi funksion i natyrshëm (rol ligjor) i kryetarit të Bashkisë, i cili ndërlidhet me konsultimin publik në kuadër të dispozitave të ligjit 139/2015 është caktimi/emërimi i koordinators për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik (neni 16, pika 2). Kjo kompetencë e tij buron nga pika "g" e nenit Neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë", e cila përcakton shprehimisht se kryetari i bashkisë "emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil".



Faksimile e njoftimit të Bashkisë Tiranë për konsultim publik

Lidhur me konsultimin publik dhe mjedisin mundësues (përfirë atë ligjor) kanë ardhur në rritje ankesat nga aktorët e specializuar të shoqërisë civile që punojnë në nivel vendor. Si ligji i ri 139/2015 "Për vetë qeverisjen vendore" ashtu edhe ligji pararendës Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" nuk përmbajnë sanksione për rastet e keq-administrimit të procesit.

Neni 64

Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca dhe detyra:

a) ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit përkatës;

b) zbaton aktet e këshillit;

c) merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës së përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;

ç) raporton në këshill për gjendjen ekonomikofinanciare të bashkisë dhe njësive administrative përbërëse të paktën çdo 6 muaj ose sa herë kërkohet nga këshilli;

d) raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë; dh) është anëtar i këshillit të qarkut;

e) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, zëvendëskryetarin/zëvendëskryetarët e bashkisë dhe i shkarkon ata;

ë) emëron, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, administratorët e njësive administrative /lagjeve dhe i shkarkon ata;

f) vendos për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërive tregtare në pronësi të bashkisë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve e të institucioneve në varësi;

g) emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë të strukturave dhe njësive në varësi të bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin për nëpunësin civil;

gj) ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhëniet me të tretët;

h) merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;

i) kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkisë. Në rastin e kthimit të vendimit të këshillit nga kryetari i bashkisë, këshilli mund të miratojë të njëjtin vendim vetëm me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve; j) miraton strukturën, organikën e kategoritë /klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) emëron dhe shkarkon nëpunësit vendorë për barazinë gjinore;

l) kujdeset për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, dhe siguron publikimin e tyre.

Mbledhja e Këshillit dhe Votimi

Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit bashkiak, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij (neni 17, ligji 139/2014).

Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rastit kur ky ligj parashikon ndryshe.

Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve në rastet kur këshilli bën vendimarrjet e mëposhtme:

- a) zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, kryetarin dhe zëvendëskryetarët e këshillit dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit bashkiak; ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi; d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkëthemelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
- f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë;
- i) zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar;
- j) vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji

Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit kur ky i fundit për miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve (germa "e", neni 54). Në një rast të tillë, pra kur tjetërsohen prona, është i domosdoshëm si konsultimi paraprak ashtu edhe votimi i cilësuar. Ligjvënësi jo pa qëllim ka vendosur kritere të forta që duhen zbatuar në rastin e një vendimarrje të tillë.

Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave. Në këtë rast fitues shpallet kandidati që ka numrin më madh të votave dhe, nëse votat janë të barabarta, fituesi caktohet me short.

Njoftimi dhe hyrja në fuqi

Njoftimi i vendimarrjes është faza përblylëse e procesit vendimarrës. Njoftimi është procesi përmes të cilit vendimarrja merr forcë ligjore. Hyrja në fuqi e aktit përmes njoftimit përshkruan atë fazë të procesit ligjvënës kur akti tashmë i miratuar sipas një procedurë ligjore hyn në domenin publik juridik brenda të cilit ushtron juridiksionin e vet organi i qeverisjes vendore për të prodhuar efektet e synuara juridike nga ky i fundit (këshilli bashkiak në rastin konkret). Pa njoftim, i gjithë procesi vendimarrës është nul juridikisht.

Në pikën 6 të nenit 55 përcaktohet shprehimisht se *"Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to"*.

Një tjetër përcaktim që ka të bëjë me këtë fazë të procesit vendimarrës gjendet edhe në kapitullin VI të ligjit 139/2015 dhe konkretisht në nenin 18 të tij, i cili mban titullin "Seancat e këshillimeve me bashkësinë". Konkretisht në paragrafin 3 të këtij neni thuhet shprehimisht se *"Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim"*.

Do të ishte mirë nëse ky proces kaq i rëndësishëm, siç është njoftimi i vendimarrjes, të përmbliidhej dhe normohej në një nen të vetëm dhe jo të shpërndahej apo amalgamohej, sipas rastit, në nene jo dhe aq relevante. Megjithatë në kuadër të metodologjisë që do të përdoret për këtë vlerësim, dispozitat përkatëse do të ri-grupohen për efekt të koherencës metodologjike.

Një nga mënyrat e njoftimit të vendimarrjes që ka gjetur më shumë terren kohët e fundit është ajo përmes publikimit në faqet zyrtare të internetit të bashkive. Njoftimi proaktiv i akteve është në thelb parimi që është adoptuar nga Republika e Shqipërisë për botimin zyrtar të akteve juridike nga organet qendrore kushtetuese (dhe/ose të pavaruara), aktet e të cilave hyjnë në fuqi përmes botimit në fletore zyrtare dhe jo përmes njoftimit fizik të subjekteve që ato adresojnë. Parimi i prezumimit të njoftimit aplikohet edhe për aktet me karakter individual (VKM etj). Pretendimet se aktet i duhen njoftuar në shtëpi banorëve, madje edhe në fshatrat më të largëta, të bëra edhe së fundmi nga disa aktorë të shoqërisë civile janë diletanteske dhe larg standarteve bashkëkohore që Shqipëri ka adoptuar tashmë në legjislacionin e saj, përfshi edhe atë për qeverisjen vendore. Edhe disa ide të hedhura për botimin e vendimeve të këshillave bashkiakë në fletore zyrtare lokale në letër, janë gjithashtu të tejkaluara si nga legjislacioni ashtu edhe nga praktika, jo vetëm e vendeve europiane, por madje edhe nga praktika që aplikohet në RSH.

Një terren virtual mjaft i frekuentuar për publikimin e akteve zyrtare të bashkive (VKB) është edhe platforma kombëtare VENDIME.AL. Ajo përfaqëson arkivën qendrore ku janë të publikuara aktet e NJQV që prej vitit 2007 e deri më sot. Platforma është së fundmi edhe pjesë e angazhimeve të marra nga shteti shqiptar në kuadër të Planit III Kombëtar të Veprimit në kuadër të OGP¹⁴.

14. <https://www.opengovpartnership.org/current-commitments/17-commitment-publish-online-central-and-local-government-legislation-open>

Mbi aktet e Qeverisjes Vendore

Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, organet e njësive të qeverisjes vendore nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra¹⁵. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe (*neni 116 i Kushtetutës*). Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj (*Neni 120 i Kushtetutës*).

Ligji 139/2015 ka parashikuar në nenin 8¹⁶ të tij se “organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhrave”. Një përcaktim të tillë, ligji 139/2015 e përmban dy herë, pasi edhe në nenin 9¹⁷ ai thekson shprehimisht se: “bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra”

Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj¹⁸.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nuk definon kompetencën dhe nuk detajon karakterin e akteve me të cilat disponojnë degët e organit të qeverisjes vendore (këshilli vs. kryetari me administratën e tij). Mund të merret me mend vetëm se vendimet janë kompetencë ekskluzive e këshillit bashkiak, në të njëjtën mënyrë sikurse ligjet janë kompetencë e Kuvendit (me analogji funksionale).

Edhe për urdhrat mund të thuhet se ato janë instrumenti juridik dhe administrative me të cilat disponon kryetari i bashkisë, si titullari i degës ekzekutive të organit të qeverisjes vendore. Megjithatë ligji 139/2015 krijon një vështirësi (ose mbart paqartësi) në vlerësimin e kompetencës për të nxjerrë këtë loj akti, pasi në nenin 13 (përmendur më sipër) ai flet për “urdhra me karakter normativ” të cilat i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga Prefekti/Gjykata. Në praktikën administrative, urdhri gjithmonë adreson një subjekt juridik/individual të së drejtës dhe rrjedhimisht ai ka karakter individual. Paqartësi të tilla duhet të adresoheshin përmes akteve nënligjore që në këtë rast do të duhej të nxirreshin nga Këshilli i Ministrave.

Sa i përket Urdhëresave, kompetenca për nxjerrjen e tyre mbetet gjithashtu e pasqaruar në ligj, edhe pse implikohet se ato janë instrumenta juridike të këshillit bashkiak. Konkretisht, në nenin 69 “Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar”, gjendet ky përcaktim në paragrafin 4. “Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak¹⁹”. Në praktikën e organeve të qeverisjes qendrore, udhëzimet janë akte me natyrë normative të cilat nxirren në respekt dhe për zbatim të ligjit nga titullari përkatës, kryesisht ministrat e qeverisë. Kjo praktikë është ndjekur me sa duket edhe në rastin e disa urdhëresave të nxjerra nga kryetari i bashkisë Tiranë²⁰ të cilat kanë qartazi natyrë normative (fuqi juridike rregulluese të përgjithshme). Mbetet gjithsesi që të qartësohet më mirë natyra dhe burimi i së drejtës për llojin e aktit “urdhëresë”

15. Neni 113, paragrafi 2, Kushtetuta e Shqipërisë, e ndryshuar.

16. Neni 8, paragrafi 2. KREU III TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

17. Neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, germa “b”

18. Neni 13 Mbikëqyrja dhe kontrolli, paragrafi 2 / ligji 139/2015

19. I njëjti forulim haset edhe në pikën 3, Neni 71 “Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit”

20. <http://www.tirana.al/tirana-legjislacion/akte-te-kryetarit/>



Matja dhe vlerësimi i zbatueshmërisë

Bashkia Tiranë

Në periudhën Nëntor 2016²¹ - Nëntor 2017 rezulton se këshilli bashkiak Tiranë ka marrë 119 vendime. Prej tyre 2 i përkasin muajit nëntor 2016 dhe 4 i përkasin mbledhjes së fundit për vitin 2016, të zhvilluar në datë 29 Dhjetor²². Ndërkohë, 113 VKB janë marrë në periudhën Janar-Tetor 2017. Për vitin 2016 vargu indeksues i vendimeve mbyllet me numrin 86²³. Të gjitha vendimet e marra gjatë periudhës që analizon ky raport janë gjithashtu të shfletueshme në Platformën Kombëtare VENDIME.AL, në faqen e dedikuar Bashkisë Tiranë²⁴.

Në mbledhjen e fundit për vitin 2016, Bashkia Tiranë mori dy nga vendimet më të rëndësishme të vitit dhe konkretisht VKB 83 datë 29.12.2016 "Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor për Bashkinë e Tiranës" si dhe VKB Nr. 84, datë 29.12.2016 për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës Për Vitin 2017". Vendimi i parë u parapri nga konsultime të ndërmarra nga krerët e ekzekutivit të bashkisë me grupe interesi dhe me banorë të Tiranës sipas një kalendari të afishuar paraprakisht. Procesi konsultativ pati pasqyrim në media. Ai gjithashtu u shoqërua nga mos-aprovim i theksuar me natyrë politike nga opozita në këshillin bashkiak Tiranë, me pretendimin bazë se Plani i Përgjithshëm Vendor për Tiranën ishte miratuar njëherë më parë.

Lidhur me vendimarrjen për buxhetin 2017, disa dëgjesa u realizuan nga dega ekzekutive e bashkisë, por në vlerësimet e këtij raporti ato nuk mund të përfshihen si pjesë ligjore e procesit vendimarrës. Këshilli Bashkiak është aktori i vetëm i legjitimuar për të ndërmarrë konsultime të tilla dhe të dhënat e grumbulluar në kuadër të këtij vlerësimi sugjerojnë se ai nuk ndërmori procese konsultative, në ushtrim të funksioneve të tija ligjore. Ligji 139/2015 parashikon që seancat e këshillimeve me komunitetin janë të detyrueshme për këshillin bashkiak *përpara shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit dhe ndryshimeve të tij, kur vendos për taksat dhe tarifa vendore akteve, kur miraton tjetërsimin e pronave dhe/ose dhënien në përdorim të tretëve. (neni 18, paragrafi 1).*

Në muajin shkurt 2017, këshilli bashkiak Tiranë hapi sërish vendimarrjen për buxhetin duke e finalizuar atë me vendimin Nr.04 Date 20.02.2017 "Për një Ndryshim në VKBTiranë Nr.84 Dt. 29.12.2016 "Per Miratimin e Programit Buxhetor Afat-Mesem 2017-2019 dhe Detajimin e Buxhetit të Bashkisë së Tiranës për Vitin 2017"²⁵. Gjatë vitit 2017, këshilli bashkiak Tiranë ka marrë edhe 5 herë të tjera vendime të tilla "për ndryshim/shtesa në Buxhetin e Bashkisë 2016...". Këto vendime janë konkretisht VKB nr 29, 49, 50, 83 dhe 106. Nuk ka të dhënë që në këto rast të jenë nëndërmarrë konsultime nga ana e Këshillit, konform përcaktimit ligjor në fuqi, sipas të cilave seancat e këshillimit janë të detyrueshme si kur miratohet buxheti, ashtu dhe ndryshimet e tij (shih: neni 54, germa "dh" dhe neni 18/1).

21. Të dhënat e fundit në këtë studim janë rakorduar në datë 3 Nëntor 2017.

22. VKB 80, 81 (Nëntor 2016) dhe 82, 83, 84, 85 (dhjetor 2016)

23. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-tirane-nr-86-date-29-12-2016/>

24. <http://www.vendime.al/tirane/>

25. <http://www.vendime.al/ep-content/uploads/2017/04/VENDIM-I-KESHILLIT-BASHKIAK-TIRANE-NR-04-DATE-20.02.2017.pdf>

Sa i takon taksave dhe tarifave vendore, gjatë vitit 2016 por edhe gjatë vitit 2017, Bashkia Tiranë ka operuar me vendimin nr. 59, Dt. 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës", të ndryshuar. Ky vendim, sikurse sugjerojnë atributet e tij, është marrë në vitin 2015 dhe ka fijuar të qëndrojë në fuqi edhe për vitin 2016. Pavarësisht se legjislacioni parashikon edhe raste të tilla, praktika sugjeron se çdo vit, këshilli bashkiak duhet të bëjë vendimarrje të posaçme për taksat dhe tarifatat vjetore. Kjo është një vendimarrje e cila konsiderohet pjesë integrale e vendimarrjes për buxhetin, pasi përcakton regjimet fiskale dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat në buxhetin vjetor të bashkisë.

Nga një vlerësim më i kujdesshëm i vendimarrjes së këshillit bashkiak të Tiranës, rezulton se VKB 59/2015 ka marrë disa ndryshime dhe modifike gjatë vitit 2017 (VKB 19, 79, 84, 105). Ligji 139/2015 parashikon detyrimin e këshillit bashkiak për të thërritur konsultime kur ky i fundit vendos për taksat e tarifatat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi (neni 54, germa "f"). Germa e ligjit në këtë rast nuk parashikon konsultime gjithsesi për ndryshimet që I behen sistemit të taksave dhe tarifave vendore. Rrjedhimisht, në kuadër të vlerësimit, VKB 19, 79, 84 dhe 105 nuk do të konsiderohen si të pakonsultuara.

Prej këtyre vendimeve vlen të veçohet dhe të komentohet gjithsesi **Vendim i Këshillit Bashkiak Tiranë Nr.79 Date 26.07.2017**, "Për dhënie mendimi mbi ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm"²⁶. Ky vendimi ngjalli debat në opinionin publik dhe nje pjese të shoqërisë civile. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë mirëfilli me një vendimarrje për taksat dhe tarifatat vendore, pasi ky vendim, sikurse u përmend më sipër, ka vijuar të jetë në fuqi që nga viti 2015 (VKB 59/2015). Megjithatë, sa kohë uji është një mall shumë sensitiv dhe sa kohë në publik u krijua një ndjeshmëri e lartë mbi këtë vendimarrje të këshillit bashkiak, autorët e këtij studime mendojnë se konsultimi publik mund dhe duhej të ishte një dimension i shtuar i kësaj vendimarrje të rëndësishme, me impakt të shumëfishtë si në buxhetin e bashkisë ashtu dhe në atë familjar. Vlen të theksohet megjithatë se vendimi në fjalë nuk ka ndikim të menjëhershëm në buxhet, pasi në thelb ai ka qenë shprehje mendimi për rritje tarifash, duke marrë për bazë modele tashme ekzistuese në qytetet e tjera (Korçë, Kamëz, etj). Rasti i vendimarrjes së datës 26 Korrik 2017 të KB Tiranë është analizuar hollësisht në raportin special që ka përgatitur ekipi i INFOCIP i cili ka dokumentuar dhe vlerësuar rigorozisht të gjithë procesin vendimarrës dhe që i bashkalidhet këtij raportit²⁷

Të tjera vendimarrje të rëndësishme të këshillit bashkiak Tiranë kanë qenë ato të parashikuara nga neni 54, germa "e" dhe konkretisht për tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Edhe në këto rast ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se procesi konsultativ është i detyrueshëm me ligj dhe ndërmerret nga Këshilli Bashkiak (neni 18/1). Rezulton se gjatë vitin 2017 janë të paktën 7 vendimarrje të tilla në këshillin Bashkiak Tiranë, të cilat janë materializuar në VKB 17, 62, 85, 86, 87, 110, 111 (shih tabela). Nuk ka të dhëna se vendime të tilla i janë nënshtruar konsultimeve të thirrura nga këshilli bashkiak. Vlet të theksohet gjithsesi se kalimet pronësore mes ndërmarrjeve të vetë bashkisë kërkojnë një interpretim ligjor të hollësin nëse bin apo jo nën parashikimet që përmban enni 18/1. Konsultime të bëra në nivel të administratës së bashkisë nuk

Neni 17

Mbledhjet e këshillit të bashkisë

1. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

26. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-tirane-nr-79-date-26-07-2017/>


27. <http://www.infocip.org/al/?cat=206>



vlerësohen në kuadër të këtij raporti pasi ato nuk legjitimohen nga ligji 139/2015. Vlen të theksohet se VKB nr 62/2017 është në fakt dhënie pëlqimi nga ana e Këshillit Bashkiak Tiranë për Vkm Nr. 1069, Datë 23.12.2015²⁸ "Për Tjetërsimin e Pronësisë Shtetërore "Truall" nga Pronë Shtetërore në Pronë Private, për Shoqërinë "Bloja" Sh.P.K, Tiranë²⁸". Në rastin konkret, KM i ka dhënë pronë publike me shkëmbim një subjekt privat pikërisht në gjurmën e një investimi publik me rëndësi të madhe për qytetin e Tiranës, i cili nga ana tjetër ka krijuar domosdoshmërinë, sikurse duket, për shpronësime në interes publik të subjekteve të tjera private që preken nga ndërtimi i këtij segmenti rrugor. Por analiza e vendimarrjes së KM nuk është në fokus të këtij studimi.

Në total vlerësohet se për periudhën që mbulon ky monitorim, janë marrë të paktën 15 VKB të cilat bien në parashikimet e nenit 18/1 dhe 54, germa "e" (miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve). Paqartësia ligjore, mbivendosja e kompetencave si dhe hamullia që ende ekziston me funksionet midis pushteti qendror dhe atij vendor e kanë vënë në vështirësi vendimarrjen e këshillit bashkiak Tiranë për këto lloj vendimarrjesh. Vetë ligji 139/2015, në nenin 9 të tij përcakton shprehimisht se njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë... (c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.

Print Screen i faqes së Bashkisë Tiranë



28. [VENDIMI KESHILLIT BASHKIAK TIRANË NR.62 DATE 06.06.2017](#)

Organizimi dhe zhvillimi i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Mbledhjet e hapura

Këshilli Bashkiak Tiranë, gjatë kohës që është realizuar ky monitorim i ka zhvilluar të gjitha mbledhjet e hapura. Salla e këshillit bashkiak Tiranë ka relativisht pak hapësira fizike për të akomoduar vëzhgues të pavarur apo publik të thjeshtë. Konfigurimi i sallës megjithatë lejon që në rrjeshtin e fundit të mund të akomodohen të paktën 20 persona. Kjo është një shifër e pamjaftueshme pot ë kemi parasysh se këshilli bashkiak Tiranë merr vendime që kanë impact direct mbi 1/3 e popullatës së shqipërisë që jeton në bashkinë e madhe Tiranë. INFOÇIP ka ndjekur mbledhjet e këshillit bashkiak në sallë, duke mos hasur gjithsesi asnjë vështirësi për të siguruar akses. Madje ekipet e INFOÇIP janë mirëpritur për realizimin e këtyre detyrave si nga vetë këshilltarët ashtu edhe nga kryetari i këshillit bashkiak, Aldrin Dalipi.

Këshilli bashkiak Tiranë ka ndërtuar në këto vite traditën e transmetimit live të mbledhjeve që zhvillon, falë edhe një memorandum bashkëpunimi me TVSH. Mbledhjet transmetohen me regji qëndrore, tek e cila ka akses çdo television apo radio që ka interes për transmetimin e seancave të mbledhjeve të këshillit. Kjo është një praktikë pozitive, duke patur parasysh faktin se vendimarrja e KB Tiranë është e rëndësishme për thujtje 1/3 e banorëve të gjithë Shqipërisë, të cilët janë banorë të kësaj bashkie.

Mediat kanë treguar përherë një interes konstant për të përcjellë tek shikuesit e tyre mbledhjet e këshillit bashkiak të Tiranës. Pasqyrim të posaçëm ka gjetur mbledhja e datës 29 Dhjetor 2016 dhe mbledhja e datës 26 Korrik 2017, kjo edhe për shkak të vendimeve që janë dikutuar dhe më pas votuar në këto mbledhje. Gjatë punimeve të këshillit bashkiak Tiranë, gazetarët e medias së shkruar dhe asaj audio-vizuale kanë qenë gjithmonë të pranishëm. Ky është një tregues (indicator alternativ) që flet në favor të zhvillimit të hapur të mbledhjeve të këshillit bashkiak të kryeqytetit.

Në rregulloren e këshillit (e papërditësuar me ligjin e ri 139/2015) ka disa parashikime lidhur me mënyrën e akomodimit të medias dhe të të ftuarve të tjerë që ndjekin mbledhjet e këshillit. Konkretisht, në nenin 44 të rregullores së KB Tiranë përcaktohet shprehimisht se *"në fund të sallës, për atë që vendet sa ka salla, zënë vend të ftuarit dhe përfaqësuesit e medias elektronike dhe të shkruar"*.

Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes (neni 17, paragrafi 2).

INFOÇIP ka konstatuar se sekretariati teknik i këshillit bashkiak ka shpërndarë njoftime të posaçme tek *address-book* i medias, ku gazetarëve i është vënë në dispozicion disa ditë para data, ora dhe axhenda e përcaktuar për mbledhjen e këshillit. Kjo konsiderohet një praktikë e mirë e cila ndiqet edhe për organizatat e shoqërisë civile që kanë kërkuar të marrin njoftim përmes emailit për mbledhjet e këshillit bashkiak. INFOÇIP ka marrë në mënyrë të rregullt njoftimin përkatës mbledhjet e radhës. Megjithatë, nuk është konstatuar ndonjë praktikë alternative, sikurse do të ishte afishimi i njoftimeve në stendë apo përmes faqes zyrtare të internetit. Në këtë të fundit janë hedhur gjithsesi disa njoftime gjatë vitit 2016, por praktika ka stopuar në shkurt të vitit 2017 (*shih print-screen më poshtë*). Kjo rrethanë specifike megjithatë nuk e zbeh në esencë përmasën e zhvillimit të mbledhjeve të hapura sa kohë që në mënyrë proaktive vetë këshilli bashkiak prodhon sinjal dhe transmeton live mbledhjet e veta.

Lidhur me njoftimin e mbledhjes, ligji 139/2015 përmban dispozita edhe në nenin 53²⁹ të tij. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton shprehimisht se: *Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit*

29. Neni 53 "Funksionimi i këshillit bashkiak"

dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës. Një përcaktim i tillë, me sa mund të kuptohet, është ri-vendosur në nenin 53 për të normuar këtë herë procesin e njoftimit të këshilltarëve. Nga pikëpamja e teknikës legjislativë të përdorur, rivendosja në dy nene të ndryshme e procesit të njoftimit të mbledhjes është a-tipike. Në mbledhjen e datës 26 Korrik 2017, këshilltarja bashkiake M.Bogdani ngriti në

Neni 57 Sekretari i këshillit bashkiak

1. Sekretari i këshillit emërohet dhe shkarkohet nga këshilli bashkiak, në bazë të propozimit të kryetarit të këshillit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit. Shkarkimi i sekretarit mund të propozohet edhe nga 1/3 e anëtarëve të këshillit.
2. Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës për:
 - a) mbajtjen e dokumenteve zyrtare të këshillit;
 - b) ndjekjen e punës për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve, sipas rendit të ditës;
 - c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit;
 - ç) shpalljen dhe publikimin e njoftimeve e të akteve të nxjerra nga këshilli bashkiak;
 - d) përgatitjen e seancave të këshillimit me bashkësinë;
 - dh) mbikëqyrjen e respektimit të rregullores së funksionimit të këshillit.

hapje të diskutimit të saj shqetësimin se kishte marrë njoftim vetëm 2 ditë para mbi projekt-vendimet. Ky mund të ketë qënë githsesi një rast i izoluar që mund të ketë patur të bëjë vetëm më të. Ajo që mund të thuhet me siguri është se njoftimi për këtë mbledhje nuk bë në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, sikurse e demonstroi edhe foto më sipër (*print screen dt. 6 nëntor 2017*). Në një rast të tillë, përgjegjësia ligjore bie mbi sekretarin e këshillit bashkiak, i cili ka funksione të përcaktuara qartësisht në nenin 57 të ligjit 139/2015. Konform përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, Sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës ndër të tjera për: c) *njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit*;

Nga monitorimi i praktikës vendimarrëse të këshillit bashkiak Tiranë në periudhën Nëntor 2016-Nëntor 2017, nuk rezulton të ketë patur kërkesë nga 1/3 e këshilltarëve për të bërë mbledhje me dyer të mbyllura. Në këtë kuptim, parashikimet që përmban neni 17, paragrafi 3 nuk janë aktivizuar asnjëherë nga këshilli bashkiak Tiranë³⁰.

Votimi

Konform përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak Tiranë ka 61 këshilltarë. Tirana është e vetmja bashki në RSH që ka një numër kaq të madh këshilltarësh, konform parashikimeve që përmban neni 46³¹ i ligjit 139/2016.

Kuorumi i domosdoshëm për të deklaruar të hapura mbledhjet e këshillit bashkiak është 31 këshilltarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë e cilësuar për marrjen e vendimeve. I vetmi rast i parashikuar në nenin 55 "Votimi", në të cilin kërkohet votim me shumicë të cilësuar është kur këshilli bashkiak "miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve". Me fjalë të tjera, kur në axhendën e mbledhjes së rradhës ka për votim projekt-vendime që bien brenda parashikimeve të nenit 54, germa "e", sipas një interpretimi të INFOÇIP, kuorumi i domosdoshëm për të deklaruar të hapur mbledhjen duhet të jetë 3/5 e numrit të përgjithshëm të gjithë anëtarëve të këshillit. Në rastin e Këshillit Bashkiak Tiranë, 3/5 do të përkthehej në 37 anëtarë.

30. Në procesin e konsultimit legjislativ në komisionin parlamentar të ligjeve për projekt-ligjin 139/2015, INFOÇIP ka depozituar zyrtarisht amendament për abrogimin tërësor të dispozitave që përmban neni 17, paragrafi 3.

31. Neni 46 "Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak" - 1. Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë: - Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë; - Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë; - Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë; - Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë; - Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë; - Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë.

Nga monitorimi i realizuar rezulton se të gjitha mbledhjet që ka zhvilluar KB Tiranë në periudhën nëntor 2016- nëntor 2017 janë hapur me kuorumin e domosdoshëm prej 31 anëtarësh. Në total janë vetëm katër mbledhje në të cilat janë përfshirë në axhendë projekt-vendime që bien nën parashikimet ligjore për hapje mbledhje me shumicë të cilësuar të këshilltarëve të pranishëm. Këto janë mbledhjet e zhvilluar në datat 20/02/2017, 6/6/2017, 26/7/2017 dhe 28/9/2017. Me përjashtim të mbledhjes së datës 26/7/2017³², të gjitha mbledhjet e tjera të monitoruara kanë qenë me kuorum të cilësuar (mbi 37 këshilltarë në sallë në hapje të mbledhjes).

Neni 53

Funksionimi i këshillit bashkiak

...

7. Mbledhja e këshillit bashkiak quhet e vlefshme kur në të merr pjesë shumica e të gjithë anëtarëve të këshillit, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë tjetër për marrjen e vendimeve, sipas përcaktimeve në nenin 55 të këtij ligji.

...

Neni 54

Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

...

e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;

...

Neni 55

Votimi

...

4. Vendimet merren me jo më pak se tre të pestat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastin e parashikuar në shkronjën "e", të nenit 54, të këtij ligji.

...

Në vlerësimin e INFOÇIP, neni

53, pika 7 e ligjit 139/2015 krijon vëshirësi në funksionimin normal të këshillit bashkiak. Kjo pasi në axhendën e planifikuar për një mbledhje të rradhës, mund të ketë vendime të cilat merren me shumicë të thjeshtë të cilat nuk ka arsye të ngelen pa vendimarrje për shkak se në axhendë ka edhe vendime që kërkojnë shumicë të cilësuar. Rekomandohet rishikim i kësaj dispozite në të ardhmen kur ligji 139/2015 t'i nënshtrohet amendimeve të mundshme.

Procesi i diskutimit dhe votimit në këshillin bashkiak Tiranë është dinamik. Ai është menaxhuar me kompetencë dhe profesionalizëm nga kryetari i këshillit bashkiak, z. Aldrin Dalipi. Axhenda e mbledhjes dhe pikat shtesë të saj janë miratuar konform përcaktimeve ligjore që në fillim të mbledhjes pas marrjes së kuoromit nga sekretari i këshillit bashkiak.

Nuk janë vënë re parregullsi në procedurën e votimit të projekt-vendimeve në përgjithësi. Komisionet e përhershme të këshillit janë lejuar rregullish, konform parashikimeve ligjore në fuqi të ofrojnë shpjegime për projekt-aktet para miratimit të tyre.

Neni 55 "Votimet" parashikon në pikën 1 të tij se *votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë*. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. *Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur*.

Nga monitorimi rezulton se të gjithë vendimarrjet e realizuar në KB Tiranë janë berë me votim të hapur (periudha Nëntor 2016-Nëntor 2017). Nuk rezulton në asnjë rast që 1/3 e këshilltarëve të ketë depozituar kërkesë për votim të fshehtë. Vlen të theksohet se vendimet konstituive që parashikohen nga dispozitat e nenit Neni 48³³ janë realizuar me votim të fshehtë dhe me shumicën e gjithë votave të të gjithë anëtarëve të këshillit (germat "a", "b" dhe "c" të nenit 54, referuar nga neni 55, pika 3). Gjithsesi kjo është një e dhënë e cila del jashtë kornizës kohore të cilën mbulon ky monitorim.

32. Shih raportin special për këtë mbledhje në kapitullin 2.

33. Neni 48 Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

Rezulton se edhe buxheti është miratuar konform përcaktimit ligjor (pika "dh", neni 55 referuar nga neni 53, pika 3). Vendimarrja për taksat dhe tarifat vendore, e parashikuar nga germa "f" e nenit 54 nuk është konsumuar gjatë kohës që mbulon ky monitorim.

Sa i takon VKB-ve për marrje dhe shlyerje detyrimesh (germa "g" neni 54), rezulton gjithashtu se është respektuar kuorumi i kërkuar. Parashikimet që përmban germa "gj" dhe "h" e nenit 54 nuk janë aktivizuar në praktikën vendimarrëse dhe/ose nuk janë verifikuar në praktikën e monitoruar.

Pavarësisht se del jashtë kornizës kohore të këtij monitorimi, rezulton se KB Tiranë ka respektuar edhe përcaktimet që parashikohen në gërmën "i" të nenit 54; vendimarrja për zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut është votuar konform përcaktimit ligjor. Rezulton që në këtë vendimarrje është mbajtur parasysh edhe dispozita sipas së cilës përfaqësuesit e KB në këshillin e qarkut në jo më pak se 50 përqind të tyre, duhet t'i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar. Konkretisht në këshillin bashkiak Tiranë, gjinia më pak e përfaqësuar është ajo mashkullore (ka 32 këshilltare dhe 29 këshilltarë), ndërkohë që në Këshillin e Qarkut janë zgjedhur 10 përfaqësues dhe vetëm 8 përfaqësuese³⁴ (vlerësimi aplikohet deri në momentin e mbledhjes së KB të datës 26 Korrik 2017).

Një moment diskutimi është vendimarrja e realizuar në mbledhjen e datës 26 Korrik 2017 sa i takon dhënies së mandatëve këshilltarëve të rinj të cilët zunë vendin e atyre që u zgjedhën deputetë në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të Qershorit 2017. Neni 55, pika 3, i ngarkon këshillit bashkiak detyrimin të votojë me shumicën e votave të gjithë anëtarëve për rastet kur: j) *vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji*. Në rastin konkret, është aktivizuar dispozita që përmban germa "c" e paragrafit 1 të nenit 49. Konkretisht, në referimin që kjo dispozitë bën (neni 47), *funkcioni i këshilltarit bashkiak është i papajtueshëm me atë të deputetit* (neni 47/1, germa "ç", ligji 139/2015).

Këshilli Bashkiak Tiranë ka votuar 7 vendime për pranim dorëheqje nga mandati për shkak të krijimit të kushteve të papajtueshmërisë si dhe për 5 nga këto shtatë vendime është votuar gjithashtu për dhënien e mandatit këshilltarëve zëvendësuar, konform parashikimeve që përmban pika 1 e nenit 49.

Pas hapjes së mbledhjes me kuorum prej 32 anëtarësh, këshilltarët e PD në këshillin bashkiak Tiranë janë larguar nga mbledhja, ndërkohë që këshilltarët e LSI (me vetëm një përjashtim) nuk kanë qenë të pranishëm në sallë. Votimi për dhënien e 5 mandateve të reja është bërë në kushtet kur në sallë nuk kanë qenë të pranishëm më shumë se gjysma e gjithë anëtarëve të këshillit (shih raportin special, shtojca 1).

INFOÇIP konsideron se dispozitat ligjore që përmban ligji 139/2015 duhen ri-parë në këtë drejtim. Konstatohet se ka një përplasje mes kompetencave të KQZ i cili, konform misionit të tij kushtetues dhe ligjor jep de-jure dhe de-facto mandatet e këshilltarëve

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.
2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
 - a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
 - d) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
 - e) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykatë;
 - f) vdes;
 - g) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
 - h) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykatë të formës së prerë;
 - i) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.
5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

34. <http://www.qarkutirane.gov.al/sq/perberja>

dhe rolit të këshillit i cili duhet të administrojë mandatet e reja në kushte të pafavorshme numerike. Ligji 139/2015 i ka veshur këshillit bashkiak attribute të ekzagjeruara në raport me vendimarrjen për mandatet e reja të këshilltarëve zëvendësues duke shtënë në kontradiktë vullnetin e shprehur përmes votës popullore (marrja e mandateve përmes KQZ që administron numërimin e votës dhe ndarjen e mandateve sipas rezultateve të votimit) me vullnetet politike në këshillin bashkiak të përfaqësuesve lokalë. Kjo kontradiktë duket se ka kompromentuar zhvillimin normal të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 26 Korrik 2017, duke degjeneruar procesin deri në konflikt gjyqësor.

Në terma konkretë: paragrafi 1 i nenit 49 të ligjit 139/2015 sipas të cilit "Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak" bie në kontradiktë me parashikimet që përmban Kodi Zgjedhor, i ndryshuar (neni 164³⁵). Kjo kontradiktë theksohet më tej në parashikimet që përmban neni 45³⁶ i ligjit 139/2015 sipas të cilit, *Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë*.

Rekomandohet që njohja e kushteve të papajtueshmërisë të mandatit të këshilltarit dhe dhënie e mandateve të reja të mos i nënshtrohet procesit të votimit në këshillin bashkiak. Harmonizimi i dispozitave ligjore që normojnë këtë proces mund dhe duhet të adresohet përmes interpretimit të Gjykatës Kushtetuese dhe/ose përmes amendimit të dispozitave që përmban ligji 139/2015 lidhur me mënyrën e votimit të dhënies dhe heqjes së mandateve të reja gjatë kohës që këshilli është i mbledhur në mandat të rregullt legjislativ vendor.

Të gjitha mbledhjet e këshillit bashkiak Tiranë protokollohen në format audio dhe më pas zbardhen nga sekretariati teknik. Kjo është një praktikë e cila parashikohet edhe në rregulloren e këshillit, pavarësisht se kjo e fundit vijon akoma të jetë e papërditësuar³⁷ me përcaktimet e reja që përmban ligji 139/2015³⁸. Sipas nenit 43, paragrafi 3 i Rregullores së KB Tiranë, "Proces-verbali në Këshill, mund të mbahet edhe me stenografi ose me mjete incizimi (magnetofon). Gjithsesi, edhe në këto raste, teksti e tij hidhet në letër dhe firmoset sipas rregullit të mësipërm". Kjo praktikë është për t'u përgëzuar, pasi mundëson zbardhjen e saktë të diskutimeve në këshill, duke patur parasysht edhe dinamikën e forta që këto mund të kenë herë pas here, të cilat do ta vështirësonin shumë punën e sekretarit të këshillit bashkiak për të realizuar një protokollim klasik (në letër teksa ndodhin diskutimet).

Megjithatë, edhe në këtë rast, parashikimet duhet të vendosen në tekstin e një rregulloreje të përditësuar, e cila të jenë në përputhshmëri me përcaktimet ligjore në fuqi dhe jo me ligje tashmë të shfuqizuara.

Salla e këshillit bashkiak Tiranë është e pajisur me sistem elektronik audio-video, e cila mundëson aplikime teknike dhe teknologjike që lehtësojnë procesin vendimarrës dhe protokollimin e tij. Megjithatë, sistemi elektronik në sallë nuk mundëson "leximin" e kuoromit. Këshilli Bashkiak Tiranë ka një numër prej 61 këshilltarësh dhe marrja e kuoromit për hapjen e mbledhjes apo për realizimin e vendimarrjeve të ndryshme sipas parashikimeve dhe detajimeve që përmban neni 55 i ligjit 139/2015 është i vështirë të realizohet e efektivisht nga kryetari apo edhe nga kryesia e këshillit bashkiak.

35. Neni 164 "Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës", paragrafi 2: Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

36. Neni 45 "Mënyra e zgjedhjes", http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/249.pdf

37. <http://www.tirana.al/keshilli-bashkiak/rregullorja-e-keshillit-bashkiak/>

38. Neni 43 "Proces-verbali i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak" 1) Në mbledhjet e Këshillit mbahet proces-verbal nga sekretaria e Këshillit; 2) Në fund, pasi proces-verbali kontrollohet, firmoset nga Sekretari dhe së paku nga 3 këshilltarë; 3) Proces-verbali në Këshill, mund të mbahet edhe me stenografi ose me mjete incizimi (magnetofon). Gjithsesi, edhe në këto raste, teksti e tij hidhet në letër dhe firmoset sipas rregullit të mësipërm; 4) Shirat e incizimit me magnetofon, ruhen deri në një vit.

Nga monitorimi në sallë i mbledhjeve të këshillit bashkiak, kryetari i këshillit ka treguar kujdes gjithsesi që të vlerësojë në fillim të çdo mbledhje kuorumin e këshilltarëve për të shpallur mbledhjen e hapur. Megjithatë, në praktikën e vëzhguar por edhe në protokollin e mbledhjeve nuk konstatohen raste të prononcimit të numrit real të këshilltarëve të pranishëm, për efekt të dokumentimit audio dhe zbardhjes më pas të protokollit të mbledhjes. Ky i fundit nuk përmban të shënuar kuorumin e disponueshmë për çdo vendim të votuar. Nëse prefekti do të donte të vlerësonte vendimarrjet e këshillit bashkiak Tiranë lidhur me respektimin e dispozitave të nenit 55 “Votimi”, ai do të duhej të ishte vetë i pranishëm në mbledhje si vëzhgues, pasi të dhëna të tilla nuk mundësohen nga materiali protokollar që i vihet atij në dispozicion nga vetë Këshilli për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimarrjes bashkiake. Sikurse është bërë e qartë në vlerësimet e mësipërme, ligji 139/2015 është ligj aterial dhe procedural, i cili përcakton qartësisht deri edhe modalitetet e votimit të projekt-vendimeve. Në këtë pikë, jashtë një vlerësimi koherent të kuoromit për çdo vendim dhe fiksimit të tij në procesverbalin e votimit të aktit, Prefekti i Qarkut e ka objektivisht të pamundur të përformojë misionin e tij ligjor.


Publikimi i vendimeve

Njoftimi i vendimarrjes është faza përmbyllëse e procesit vendimarrës. Njoftimi është procesi përmes të cilit vendimarrja e këshillit bashkiak merr forcë ligjore. Në kapitullin VI të ligjit 139/2015 dhe konkretisht në nenin 18 të tij³⁹, thuhet shprehimisht se “Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësive vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim”.

Nga monitorimi i këshillit bashkiak Tiranë rezulton se vendimet e tij janë të publikuara me një rregullsi të kënaqshme në faqen zyrtare të internetit, në një kategori/rubrikë të posaçme⁴⁰ brenda faqes. Në kategorinë përkatëse gjendet e plotë arkiva e vendimeve të Këshillit që nga viti 1993. Kjo përfaqëson edhe arkivën më të plotë të vendimeve krahasuar me të gjitha bashkitë e vendit.

Në vlerësimet e para të projektit, në periudhën Nëntor-Dhjetor 2016, Bashkia Tiranë nuk i kishte të publikuara në faqen e saj vendimet e këshillit për periudhën 2015-2016. Bashkia Tiranë nuk ka patur të publikuara vendime të këshillit gjithashtu gjatë periudhës 2011-2015.

Në Shkurt 2017, në kuadër të nismës së mbështetur nga Lëviz Albania, INFOÇIP ndërmoi një vlerësimin të posaçëm në Bashkinë Tiranë për vlerësimin e konsistencës në publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak. Nga vlerësimi rezultonte se vendimet e mbledhjes së fundit për vitin 2016, e mbajtur në 29 Dhjetor⁴¹ nuk ishin të hedhura në faqen e internetit. Në vlerësimin e



39. “Seancat e këshillimeve me bashkësinë”

40. <http://www.tirana.al/keshilli-bashkiak/vkm/>


41. Në këtë mbledhje u miratuan gjashtë vendime shumë të rëndësishme, mes të cilave, “Miratimi i planit të përgjithshëm vendor për bashkinë e Tiranës” dhe “Programi buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimi i buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

dytë, atë të muajit Mars-Prill 2017, INFOÇIP konsatoi që databaza e vendimeve të këshillit kishte filluar të rikuperohej me ritme të shpejta. Stafi i caktuar për këtë detyrë nga Bashkia Tiranë ka publikuar deri në mes fund të muajit shkurt 2017 vendime të këshillit bashkiak që nga periudha e para-ndarjes administrative.

INFOÇIP ndërmori një vlerësim të konsistencës së vargut indeksues të vendimeve të këshillit bashkiak Tiranë për vitin 2015, 2016 dhe 2017, të cilat përkojnë edhe më kohën e ushtrimit të mandatit të këshillit pas Ndarjes së re Administrative. Nga vlerësimi rezultoi se vargut indeksues ishte i paplotë dhe se mungonin vendimet e mëposhtme:

- **VITI 2015 – vendimet nr:** 13, 29, 33, 47, 48, 49, 53, 54, 55, 56, 57;
- **VITI 2016 – vendimet nr:** 1, 2, 3, 4, 5, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 41, 42, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 84, 85,
- **VITI 2017 – vendimet nr:** 1, 2, 20, 23.

Për të disponuar vendimet të cilat vijonin të ishin të pabotuara ende, INFOÇIP depozitoi kërkesë për informim për të disponuar vendimet e këshillit bashkiak që mungonin. Kjo kërkesë, u protokollua konform rregullave që parashikon ligji 119/2014 "Për të drejtën e Informimit". Për të vlerësuar objektivisht gadishmërinë e institucionit të Bashkisë Tiranë, kërkesat për informim u përpiluan në emër personal të bashkëpunëtorëve (të ekipit të INFOÇIP). Bashkia Tiranë iu përgjigj kërkesave për informim brenda afateve ligjore të përcaktuara duke vënë në dispozicion vendimet e kërkuara. Me marrjen e tyre, ato u procesuan në Platformën Kombëtare VENDIME.AL. Bashkia Tiranë, duke marrë dijeni të mungesave të konstatuara, gjithashtu plotësoi vargun indeksues në faqen e saj zyrtare në Maj 2017.



Hyrja në fuqi e vendimeve

Publikimi në faqen zyrtare i akteve të bashkisë i shërben garantimit të transparencës vendimarrëse por njëkohësisht edhe cakton kohën/momentin e hyrjes së tyre në fuqi. Në pikën 6 të nenit 55 përcaktohet shprehimisht se “*Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to*”.

Nga monitorimi rezulton se respektimi i këtyre afateve është sporadik. Shkaku kryesor në këtë rast ka të bëjë me mos-përcaktimin e modaliteteve të procedurës së shpalljes në ligj si dhe me afatet e konfirmimit të ligjshmërisë nga prefekti. Një tjetër vështirësi në respektimin e këtyre afateve është diferencimi i mënyrës së hyrjes në fuqi të VKB me natyrë natyrë normative dhe atyre me natyrë individuale. Për këto të fundit, ligji sugjeron *hyrjen në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to*. Kjo përbën një vështirësi të lartë sa i takon matjes dhe vlerësimit të kohës fizike se inicimit të njoftimit dhe marrjes së subjektit dijeni për të. Në sugjerimet që INFOÇIP depozitoi në Komisionin Parlamentar të Ligjeve në kohën e konsultimit të projekt-ligjit 139/2015, kërkohej mos-diferencim i akteve sa i takon modaliteteve të hyrjes në fuqi dhe adoptim të plotë të aprimit të prezumimit të njoftimit përmes publikimit online. Ky parim është adoptuar tashmë nga Shqipëria për publikimet zyrtare në tërësi. Për fat të keq, kjo nuk u morr parasysh në fazën e konsolidimit të projektligjit “Për vetë qeverisjen vendore”. Në këtë drejtim, ligji 139/2015 përfaqëson një kthim prapa në raport me kuadrin ligjor që Shqipëria ka adoptuar për futjen në fuqi të akteve të organeve qëndrore kushtetuese dhe më gjerë.

Një tjetër vështirësi në këtë drejtim është edhe vetë kapaciteti profesional i burimeve njerëzore të cilat përfaqësojnë administratë të këshillave bashkiakë, të cilët duhet të seleksionojnë teknikisht se cilat vendime hyjnë në fuqi përmes shpalljes dhe cilat përmes njoftimit të subjekteve që akti adreson. Përveç Tiranës, e cila ka gjithsesi një sekretariat teknik pranë Këshillit Bashkiak, të gjitha bashkitë e tjera do të duhet të mbështeten për këtë lloj vlerësimi tek sekretarët e këshillave, të cilët jo domosdoshmërisht duhet të jenë (apo janë) jurist në profesion.

Videoarkiva e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Tiranë

Në funksion të promovimit të një përmase sa më të hapur për vendimarrjen e këshillave bashkiakë që targetoi ky studim, por edhe në funksion të realizimit të një monitorimi sa më objektiv, INFOÇIP realizoi një videoarkivë të plotë mbledhjeve të këshillit bashkiak Tiranë, e cila mbulon periudhën Nëntor 2016-Tetor 2017. Kjo videoarkivë është e disponueshme në kanalën zyrtar në Youtube të INFOÇIP⁴². Të gjitha verifikimet post-factum janë bërë duke konsultuar në mënyrë të vazhdueshme edhe videoarkivën e mbledhjeve të këshillit bashkiak. INFOÇIP synon ta vijojë këtë iniciativë, duke i dhuruar si fillim bashkisë Tiranë të gjithë videoarkivën në portalin e saj më të ri të hapur <http://opendata.tirana.al/>, me ndihmesën e Agjensive të Kombeve të Bashkuara.



42. https://www.youtube.com/results?search_query=mbledhja+e+keshillit+bashkiak+tirane+infocip



Bashkia Kamëz

Matja dhe vlerësimi i zbatueshmërisë

Në periudhën Nëntor 2016⁴³- Nëntor 2017 rezulton se këshilli bashkiak Kamëz ka marrë 154 vendime. Prej tyre 40 i përkasin periudhës Nëntor-Dhjetor 2016. Për vitin 2016 vargu indeksues i vendimeve mbyllet me numrin 168⁴⁴. Ndërkohë, 114 VKB janë marrë në periudhën Janar-Tetor 2017. Të gjitha vendimet e marra gjatë periudhës që analizon ky raport janë gjithashtu të shfletueshme në Platformën Kombëtare VENDIME.AL, në faqen e dedikuar Bashkisë Kamëz⁴⁵.

Për të njëjtën periudhë, Bashkia Kamëz ka marrë më shumë vendime krahasuar me këshillin bashkiak Tiranë. Një nga arsyet që meriton të përmendet në fillim të këtij vlerësimi është fakti se Prefekti i Qarkut në mënyrë sistematike ka kthyer mbrapsht për rishqyrtim në këshill bashkiak pjesën dërrmuese të vendimeve të marra nga këshilli. Kjo e ka detyruar këtë fundit të zhvillojë nga dy mbledhje në muaj, në ushtrim të kompetencave të veta duke e kaluar përgjithësisht vendimarrjen e tij të mëparshme pa ndryshime.

Nuk rezulton që Prefekti të këtë adresuar ankesa në gjykatën administrative për rikualifikimin e vendimarrjes pa ndryshime nga këshilli bashkiak Kamëz. Kjo padyshim ngarkon me përgjegjësi Institucionin e Prefektit i cili, në vlerësimet e këtij raporti ka konsumuar element të shpërdorimit të detyrës.

Nga ana tjetër është fakt se Bashkia Kamës ka fituar një gjyq në gjykatë administrative ndaj institucionit të prefektit për çështje të kthimit sistematik të vendimarrjes. Procesi gjyqësor është fituar në shkallë të parë nga Bashkia Kamëz dhe është në pritje të gjykimit në shkallë të dytë të gjykatës administrative.

Në mbledhjen e 23 Nëntorit 2016, Këshilli Bashkiak Kamëz ka marrë vendimin Nr. 140 Dt. 23.11.2016 "Mbi Sistemin dhe Tarifave Vendore për Vitin 2017"⁴⁶. Nuk rezulton që Këshilli Bashkiak të ketë thirrur dhe të ketë organizuar vetë dëgjese për këtë vendimarrje. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak është aktori i vetëm i legjitimuar për të ndërmarrë konsultime mbi taksat dhe tarifat vendore (shih parashtrimet më sipër).

Nuk rezulton që media të ketë raportuar mbi ndonjë proces konsultativ për Paketën Fiskale 2017. Një proces të tillë nuk e dokumenton dhe nuk e pohon as gazeta zyrtare e bashkisë Kamëz⁴⁷. Në fakt interesi mediatik për bashkinë Kamëz ka qenë i ulët dhe kjo mbetet një fakt i pashpjegueshëm nëse mbahet parasysh fakti se është një ndër tre bashkitë më të mëdha në vend, me një numër banorësh që i kapërcen 100 mijë.

43. Të dhënat e fundit në këtë studim janë rakorduar në datë 3 Nëntor 2017.

44. <http://www.vendime.al/category/kamez/2016-kamez/>

45. <http://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-kamez/>

46. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr140-date-23-11-2016/>

47. file:///C:/Users/Gerti/Downloads/gazeta_kamza_191.pdf

LIGJ Nr. 107/2016
PËR PREFEKTIN E QARKUT

Neni 16

Verifikimi i ligjshmërisë së akteve

1. Zbatimi i akteve të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore bëhet në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

2. Prefekti i qarkut bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e mëposhtme:

a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre. Marrja dijeni nga prefekti i qarkut për aktin e depozituar nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore vërtetohet me regjistrimin e tij në zyrën e protokollit të prefektit;

b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, sipas procedurave të mëposhtme:

i) në rastet kur vëren papajtueshmëri ligjore të aktit, prefektit të qarkut i lind e drejta t'ia kthejë atë organit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke argumentuar shkeljet e vërejtura. Në këtë rast, organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore rishqyrton aktin;

ii) vendimi i marrë nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, pas rishqyrtimit të aktit të kthyer nga prefekti i qarkut, depozitohet pranë prefektit të qarkut me të njëjtën procedurë dhe afat sipas përcaktimit të shkronjës "a", të kësaj pike;

iii) në rast se vërehen përsëri papajtueshmëri ligjore në aktin e rishqyrtuar, prefekti i drejtohet gjykatës kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës është 6 organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të këtij akti. Prefekti i qarkut ka të drejtën e kthimit vetëm një herë të një akti;

iv) në rastet kur vëren shkelje ligjore në akt dhe vlerëson se kthimi i aktit nga organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk do të jetë i frytshëm, prefektit i lind e drejta që, pa ndjekur procedurën e përcaktuar në shkronjën "b", nënparagrafi "i", të kësaj pike, të kërkojë pavlefshmërinë e aktit drejtpërdrejt në gjykatën kompetente për çështjet administrative, nën juridiksionin e së cilës ndodhet organi i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kur kërkon pavlefshmërinë e aktit në gjykatë, prefekti i qarkut njofton organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 17

Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve

1. Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, kur nuk përcaktohet ndryshe në akte të tjera ligjore, jo më pak se një herë në 3 muaj.

2. Në rast se gjatë verifikimit në vend të ligjshmërisë prefekti i qarkut konstaton akte, të cilat nuk janë depozituar tek ai, sipas procedurës së parashikuar në nenin 16, të këtij ligji, kërkon pavlefshmërinë e tyre në gjykatën kompetente për çështjet administrative.

Një fakt tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me vendimarrjen për buxhetin, është edhe vendimarrja mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë dhe ndërmarrjeve të vartësisë për vitin 2017. Në rastin konkret, Këshilli Bashkiak Kamëz ka ndjekur rigorozisht protokollin e vendimarrjes duke votuar VKB 157 DATE 15.12.2016 *"Mbi miratimin e nivelit të pagave të Bashkisë Kamëz dhe ndërmarrjeve të vartësisë për vitin 2017"*⁵⁹.

Në mbledhjen e datës 17 shkurt 2017, Buxheti 2017 u ndryshua me VKB nr.27 date 17.02.2017⁶⁰. Po ashtu Buxheti ka pësuar ndryshime edhe në muajin Maj 2017 (VKB 2017⁶¹). Edhe kjo vendimarrje është kthyer nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe është miratuar më pas pa ndryshime në mbledhjen e datës 19 Qershor 2017⁶².

Ligji 139/2015 parashikon që seancat e këshillimeve me komunitetin janë të detyrueshme për këshillin bashkiak *përpara shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit dhe ndryshimeve të tij* (shih: neni 54, gërma "dh" dhe neni 18/1). Nga monitorimi nuk rezulton që në rastin konkret të jenë thirrur konsultime nga këshilli bashkiak, si për miratimin ashtu edhe për ndryshimin e vendimarrjes për buxhetin 2017.

VKB 27/2017 u kthye për rishqyrtim në këshill nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe më pas u kalua pa ndryshime në mbledhjen e këshillit bashkiak kamëz të datës 20 Mars 2017⁶³. Ligji 139/2015 nuk parashikon rastet nëse duhen thirrur konsultime nëse vendimarrja për buxhetin rifutet në rendin e ditës pas kthimit për rishqyrtim nga Prefekti i Qarkut.

Në mbledhjen e datës 19 Qershor 2017, Këshilli Bashkiak Kamëz, me Vendim Nr.71 Datë 19.06.2017 kaloi projekt-buxhetit afatmesëm për periudhën 2018-2019-2020⁶⁴. Nuk rezulton që edhe në këtë rast të jenë thirrur konsultime nga këshilli. Nga vlerësimet e situatës në kuadër të këtij monitorimi, janë ndërmarrë githsesi konsulta nga organet ekzekutive të bashkisë, por kjo konsiderohet një praktikë ekstra-ligjore. VKB nr 71/2017 gjithashtu u kthye për rishqyrtim nga Prefekti, por ajo kaloi pa ndryshime nga këshilli bashkiak Kamëz në mbledhjen e datës 24 Korrik 2017⁶⁵.

Në tërësinë e tyre, të gjitha vendimarrjet për buxhetin dhe paketën fiskale si dhe ndryshimet respektive që ato kanë pësuar janë kthyer nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe më pas janë rifutur për shqyrtim në mbledhjet pas-ardhëse dhe janë kaluar pa ndryshime nga Këshilli Bashkiak Kamëz. Kjo përbën një situatë shqetësuese dhe mund të konsiderohet më përmasën e cënimit të parimeve të automonisë vendore. Nëse do ta krahasojmë situatën me Këshillin Bashkiak Tiranë, kjo e fundit nuk është përballur gjatë vitit 2016-2017 me asnjë kthim të vendimarrjes së vet nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nga monitorimi nuk rezulton që Këshilli Bashkiak Kamës të këtë marrë, për periudhën nën monitorim, vendime të parashikuara nga nenin 54, gërma "e" dhe konkretisht për tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Edhe në këto rast ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se procesi konsultativ është i detyrueshmë me ligj dhe ndërmerret nga Këshilli Bashkiak (neni 18/1).

59. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr157-date-15-12-2016/>

60. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr27-date-17-02-2017/>

61. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr64-date-22-05-2017/>

62. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr72-date-19-06-2017/>

63. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr47-date-20-03-2017/>

64. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr71-date-19-06-2017/>

65. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-n82-date-24-07-2017/>

Organizimi dhe zhvillimi i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Mbledhjet e hapura

Këshilli Bashkiak Kamëz, gjatë kohës që është realizuar ky monitorim i ka zhvilluar mbledhjet e hapura. Nga monitorimi i praktikës vendimarrëse të këshillit bashkiak Kamëz në periudhën Nëntor 2016-Nëntor 2017, nuk rezulton të këtë patur kërkesë nga 1/3 e këshilltarëve për të bërë mbledhje me dyer të mbyllura. Në këtë kuptim, parashikimet që përmban neni 17, paragrafi 3 nuk janë aktivizuar asnjëherë nga këshilli bashkiak Kamëz⁶⁶.

Salla e këshillit bashkiak Kamëz ka hapësira të mjaftueshme fizike për të akomoduar vëzhgues të pavarur apo publik të thjeshtë. Konfigurimi i sallës lejon që në rrjeshtin e fundit të mund të akomodohen rreth 15 persona. INFOÇIP ka ndjekur mbledhjet e këshillit bashkiak në sallë, duke mos hasur vështirësi për të siguruar akses. Ekipet e INFOÇIP janë mirëpritur për realizimin e këtyre detyrave si nga vetë këshilltarët ashtu edhe nga kryetari i këshillit bashkiak, Bilbil Bajraktari.

Gjatë kohës që është realizuar ky monitorim, janë ngritur megjithatë shqetësime nga një organizatë e shoqërisë civile në Kamëz, e quajtur ATA, sipas së cilës akses normal në mbledhjet e këshillit ka qenë i mohuar. Pas interesimit për këtë situatë nga grupet monitoruese të INFOÇIP, përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak Kamëz sqaruan se në praktikën e tyre të punës, gjithkush është i lejuar të ndjekë mbledhjet, kundrejt paraqitjes paraprakisht të një kërkesë konform rregullores së këshillit. Organizata ATA, e kontaktuar nga INFOÇIP ka pohuar depozitim të kërkesave nga ana e saj, në të paktën katër rast, por akses është siguruar me vështirësi për vetëm 2 mbledhje. Më pas, organizata në fjalë ka mundur të ndjekë mbledhjet, por debate për aksesin e mohuar ka vijuar me mbledhjet e këshillit edhe me tone të larta në ndonjë rast.

INFOÇIP gjithsesi nuk ka konstatuar aktorë të tjerë të cilët të kenë kërkuar apo të kenë ndjekur mbledhjen e këshillit bashkiak gjatë kohës kur është zhvilluar ky monitorim.

Këshilli Bashkiak Kamëz ka transmetuar në live stream FB mbledhjen e datës 15 Dhjetor në të cilën u kaluan vendimarrjet e rëndësishme buxhetore (shpjeguar hollësisht më sipër). Po ashtu, vendimarrjet e muajit Dhjetor 2016 janë pasqyruar hollësisht edhe në gazetën e bashkisë "KAMZA"⁶⁷. Praktika e transmetimit *live* në rrjete sociale nga aktorë të tjerë jashtë këshillit nuk ka qenë gjithsesi e preferuar apo e autorizuar. Nuk ka parashikime të tilla gjithsesi në rregulloren e këshillit bashkiak dhe në këtë rast INFOÇIP nuk do ta përdorë këtë si një indikator negativ në vlerësimin e ndërmarrjeve për këtë qëllim. Në mbledhjen e datës 15 dhjetor 2016 ka patur pjesëmarrje në sallë të kryepleqve dhe ndonjë ndërlidhësi komunitar. Po ashtu, në këtë mbledhje të pranishëm edhe anëtarët të Grupit ATA (shoqëri civile). Pjesëmarrja e grupit të monitorimit në këtë mbledhje këshilli u lehtësua nga ndërmjetësimi i këshilltares së re Fabjola Lleshi.

Mediat tradicionale në asnjë rast nuk kanë treguar interes për të përcjellë tek shikuesit e tyre mbledhjet e këshillit bashkiak të Kamzës. Kjo neglizhencë është e habitshme po të kemi parasysh se Kamza është një bashki me mbi 100 mijë banorë dhe është kaq pranë Tiranës sa që akses grupeve të xhirimit nuk do të ishte aspak problem. Harresa e mediave ndaj bashkisë Kamëz është një tregues që ngjall habi dhe është i dëmshëm në terma të interesit publik.

66. Në procesin e konsultimit legjislativ në komisionin parlamentar të ligjeve për projekt-ligjin 139/2015, INFOÇIP ka depozituar zyrtarisht amendament për abrogimin tërësor të dispozitave që përmban neni 17, paragrafi 3.

67. file:///C:/Users/Gerti/Downloads/gazeta_kamza_191.pdf

Njoftimi

Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes (neni 17, paragrafi 2).

Këshilli bashkiak Kamëz, ndryshe nga ai i Tiranës që ka një sekretariat teknik, e mbështet gjithë procesin e njoftimit tek sekretari i këshillit bashkiak. INFOÇIP ka konstatuar se sekretari i këshillit bashkiak ka shpërndarë rregullisht njoftimin për mbledhjen e rradhës tek këshilltarët. Kontakti telefonik dhe emaili janë mjetet kryesore të përdorura për këtë qëllim.

Koordinatorët e INFOÇIP pranë këshillit bashkiak Kamëz janë informuar rregullisht mbi datën e mbajtjes së mbledhjes së këshillit bashkiak. Në rastin e mbledhjes për Buxhetin 2017, mbajtur në 15 dhjetor 2016, u shprehën gjithsesi pakënaqësi për procesin e informimit të këshilltarëve për mbledhjen e Këshillit. Edhe sipas Grupit ATA, materiali i plotë i projekt-buxhetit u është dorëzuar në orën 9 të mëngjesit të po të njëjtës ditë të mbledhjes së Këshillit, duke pamundësuar konsultimin paraprak të materialit nga të gjithë Këshilltarët, një pjesë e të cilëve kanë abstenuar rendin e ditës.

Nga monitorimi në vijim prej INFOÇIP nuk është konstatuar që këshilltarët të kenë patur vërejtje për kohën dhe cilësinë e njoftimit të mbledhjeve të këshillit bashkiak.

Bashkia Kamëz ka një help-desk aktiv dhe njoftimet për mbledhjen kanë qene pjesë e rutinës së dhënies së informacioneve të kërkuara. Megjithatë, nuk është konstatuar ndonjë praktikë alternative, sikurse do të ishte afishimi i njoftimeve në stendë apo përmes faqes zyrtare të internetit. Në këtë të fundit janë hedhur gjithsesi mjaft njoftime (119 faqe me njoftime për median), por prej tyre nuk identifikohet asnjë njoftim i cili të përkojë me dispozitat që përmban neni 17, paragrafi 2 i ligjit 139/2015. Në vitin 2017, edhe publikimi i njoftimeve për media në faqen zyrtare të bashkisë nuk aplikohet më në faqen zyrtare të bashkisë. Aktiviteti i Këshilli Bashkiak, pavarësisht funksioneve të tij të rëndësishme, zë pak hapësirë në faqen zyrtare të bashkisë Kamëz.

Në kushtet e një numri të madh popullate, si dhe në kushtet kur kërkesat ligjore për transparencë sa vijnë e rritet, pritët që proceset vendimarrëse të jenë më prezente në dokumentacionin zyrtar që bashkia shpërndan përmes mjeteve të saj informimit.

Lidhur me njoftimin e mbledhjes, ligji 139/2015 përmban dispozita edhe në nenin 53⁶⁸ të tij. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton shprehimisht se: Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës. Në një rast të tillë, përgjegjësia ligjore bie mbi sekretarin e këshillit bashkiak, i cili ka funksione të përcaktuara qartësisht në nenin 57/2 të ligjit 139/2015 sipas të cilit sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës ndër të tjera për: c) njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit.

Nga vlerësimet e ekipit monitorues të INFOÇIP rezulton se në çdo rast këshilltarët kanë marrë dijeni brenda afatit për datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës nga sekretari i këshillit bashkiak.

68. Neni 53 "Funksionimi i këshillit bashkiak"

Votimi

Konform përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak Kamëz ka 41 këshilltarë⁶⁹. Salla ku ata zhvillojnë mbledhjet e tyre është modern dhe e pajisur që në fillësë me sisteme elektronike audio. Kuorumi i domosdoshëm për të deklaruar të hapura mbledhjet e këshillit bashkiak është 21 këshilltarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë e cilësuar për marrjen e vendimeve (kur miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve). Gjatë monitorimit të realizuar nga INFOÇIP, sikurse u përmend më sipër, nuk ka patur vendimarrje që bien brenda parashikimeve të nenit 54, gërma "e". Në një rast të tillë, kuorumi i domosdoshëm për të deklaruar të hapur mbledhjen, sipas një interpretimi në gërme të ligjit 139/2015 duhet të jetë 3/5 e numrit të përgjithshëm të gjithë anëtarëve të këshillit. Në rastin e Këshillit Bashkiak Kamëz, 3/5 do të përkthehej në 25 anëtarë.

Nga monitorimi i realizuar rezulton se të gjitha mbledhjet që ka zhvilluar KB Kamëz në periudhën nëntor 2016- nëntor 2017 janë hapur mbi kuorumin e domosdoshëm prej 21 anëtarësh. Përgjithësisht në mbledhjet e këshillit Bashkiak Kamëz nuk ka mungesa, pasi në secilin rast ato nuk do të mund të provokonin dot bojkot për shkak të mos-arritjes së kuoromit⁷⁰. Shumica e këshilltarëve i përkasin forcave të djathta politike. PS ka vetëm 8 këshilltarë të saj dhe 1 anëtar Partia e Unitetit Kombëtar. Deri përpara kalimit në opozitë, LSI me 9 anëtarët e saj si dhe 1 anëtar nga Fryma e Re Demokratike bënë gjithsej 19 këshilltarë, që janë gjithsesi të pamjaftueshëm.

Procesi i diskutimit dhe votimit në këshillin bashkiak Tiranë është dinamik. Ai është menaxhuar me kompetencë dhe profesionalizëm nga kryetari i këshillit bashkiak, Bilbil Bajraktari (mjek me profesion). Axhenda e mbledhjes dhe pikat shtesë të saj janë miratuar konform përcaktimeve ligjore që në fillim të mbledhjes pas marrjes së kuoromit nga sekretari i këshillit bashkiak.

Nuk janë vënë re parregullsi në procedurën e votimit të projekt-vendimeve në përgjithësi. Komisionet e përhershme të këshillit janë lejuar rregullisht, konform parashikimeve ligjore në fuqi të ofrojnë shpejtime për projekt-aktet para miratimit të tyre.

Neni 55 "Votimet" parashikon në pikën 1 të tij se *votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë*. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. *Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur*. Nga monitorimi rezulton se të gjithë vendimarrjet e realizuar në KB Kamëz janë bërë me votim të hapur (periudha Nëntor 2016-Nëntor 2017). Nuk rezulton në asnjë rast që 1/3 e këshilltarëve të këtë depozituar kërkesë për votim të fshehtë.

Rezulton se edhe buxheti është miratuar konform përcaktimit ligjor (pika "dh", neni 55 referuar nga neni 53, pika 3). Vendimarrja për taksat dhe tarifatat vendore, e parashikuar nga gërma "f" e nenit 54 është konsumuar mbi 5 herë gjatë kohës që mbulon ky monitorim. Sa i takon VKB-ve për marrje dhe shlyerje detyrimesh (gërma "g" neni 54), rezulton gjithashtu se është respektuar kuorumi i kërkuar.

Mbledhjet e këshillit bashkiak Kamëz protokollohen me shkrim. Aparaturat audio nuk vendosen në funksionim për këtë qëllim, edhe pse janë të inkuorporuar me sistemet e sallës. Parashikime më të plota duhet të vendosen në tekstin e një rregulloreje të përditësuar, e cila të jenë në përputhshmëri me përcaktimet ligjore në fuqi dhe jo me ligje tashmë të shfuqizuara.

Nga monitorimi në sallë i mbledhjeve të këshillit bashkiak, kryetari i këshillit bashkiak ka treguar kujdes gjithsesi që të vlerësojë në fillim të çdo mbledhje kuorumin e këshilltarëve për të shpallur mbledhjen e hapur.

69. Neni 46 "Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak" - 1. ... Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;

70. Deri para zgjedhjeve parlamentare 2017, e majta kishte vetëm 19 anëtarë në këshilli dhe konkretisht

Publikimi i vendimeve

Njoftimi i vendimarrjes është faza përmbyllëse e procesit vendimarrës. Njoftimi është procesi përmes të cilit vendimarrja e këshillit bashkiak merr forcë ligjore.

Në kapitullin VI të ligjit 139/2015 dhe konkretisht në nenin 18 të tij⁷¹, thuhet shprehimisht se “*Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim*”.

Nga monitorimi i këshillit bashkiak Kamëz rezulton se vendimet e tij janë të publikuara me rregullsi përmes ndërveprimit me Platformën Kombëtare VENDIME.AL.

Brenda në faqen zyrtare, ka një rubrikë të dedikuar ku janë të publikuar me rregullsi të plotë të gjitha buxhetet dhe paketat fiskale të miratuara që nga viti 2009



71. “Seancat e këshillimeve me bashkësinë”

Hyrja në fuqi e vendimeve

Publikimi në faqen zyrtare i akteve të bashkisë i shërben garantimit të transparencës vendimarrëse por njëkohësisht edhe cakton kohën/momentin e hyrjes së tyre në fuqi. Në pikën 6 të nenit 55 përcaktohet shprehimisht se *"Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to"*.

Nga monitorimi rezulton se respektimi i këtyre afateve është sporadik. Shkaku kryesor në këtë rast ka të bëjë me mos-përcaktimin e modaliteteve të procedurës së shpalljes në ligj si dhe me afatet e konfirmimit të ligjshmërisë nga prefekti. Kjo përbën një vështirësi të lartë sa i takon matjes dhe vlerësimit të kohës fizike se inicimit të njoftimit dhe marrjes së subjektit dijeni për të.

Mbi iniciativën qytetare

Iniciativa qytetare është e drejtë e parashikuar në nenin 20 të ligjit 139/2015. I vetmi rast testimi i kësaj të drejte ka ndodhur në bashkinë Kamëz gjatë kohës që mbulon ky monitorim. Pas interesimit të bërë nga INFOCIP edhe në bashki të tjera, rezulton që rasti I bashkisë Kamëz, i inicuar nga organizat ATA është i vetmi precedent në rang kombëtar që është aktivizuar konform dispozitave që përmban neni 20 dhe për këtë arsye ky rast do të trajtohet në këtë seksion të raportit.

Grupi ATA, financuar nga Lëviz Albania, mbështet fuqizimin e programeve komunitare/bashkiake me fokus rininë dhe iniciativat rinore në Bashkinë e Kamzës. Vitin e kaluar Grupi ATA i propozoi/kërkoi Bashkisë Kamëz zyrtarisht hapjes një Qendre Rinore në ambjentet e brendshme të Pallatit të Kulturës së qytetit. Gjatë muajve tetor-dhjetor, mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë ndjekur nga aktivistët e grupit "Ata".

Në mbledhjen e datës 15 dhjetor 2015, pas prezantimit të projekt-buxhetit, *këshilltarja Fabjola Lleshi propozoi (për herë të parë në Këshill propozohet një iniciativë prej një këshilltareje) projekt-propozimin e hapjes së qëndrës rinore në ambjentet e Pallatit të Kulturës*. Propozim u kundërshtua nga Kryetari i Bashkisë duke e argumentuar që Pallati i Kulturës nuk shërben si ambjent me qera për asnjë organizatë apo grup rinor pasi funksionon në bazë të një plani aktiviteteve vjetor. Këshilltarja argumentoi që për këtë projekt-propozim kanë shprehur gatishmërinë dhe mbështetjen 14 këshilltarë të tjerë dhe ftoi të gjithë ta konsideronin si propozim. Kërkesë e cila fatkeqsisht u shty për diskutim në fund të mbledhjes, dhe pastaj kaloi në heshtje.

Pas këtij momenti u kalua në Planin B, pra në mbledhjen e firmave direkt nga qytetarët dhe Grupi ATA ka raportuar se mblodhi 1280 firma, pra më shumë 1% e banorëve të Kamzës (zyrtarisht 100 000), konform parashikimeve të nenit 20, paragrafi 1. Iniciativa u propozua për t'u marrë parasysh në rendin e ditës të njëjës prej mbledhjeve (qershor 2017), por as kjo ndodhi. Këshilli bashkiak nga ana tjetër ka komunikuar në rrugë zyrtare lidhur me objektin ATA ka kërkuar të marrë në përdorim. Argumentat e paraqitur janë korekt nga ana formale. Megjithatë, precedent i Kamzës është një test me rezultat negativ për aktivizimin efikas të parashikimeve që përmban neni 20 i ligjit 139/2015. Vetë neni është i konceptuar mbi një marrëdhënie *sender-receiver*, e cila është një praktikë e pazakontë në teknikën e shkrimit legjislativ. Rekomandohet që ky nen të pasurohet më tej dhe të mundësojë efektivisht marrjen e iniciativave ligjvënëse qytetare. Po ashtu rekomandohet që te drejtat dhe përgjegjësitë e këshillit dhe ato të iniciuesve të parashikohen në nene të ndryshme, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të jenë efektivisht dhe objektivisht të matshme dhe të vlerësueshme në terma të zbatueshmërisë. Rekomandohet që në nismën ligjvënëse për iniciativën qytetare të adoptohen parashikime rigorozë procedural për nismat në nivel vendor dhe të urdhërohet harmonizimi i rregulloreve të këshillave bashkike me normativën ligjore në fuqi.



Matja dhe vlerësimi i zbatueshmërisë

Bashkiak Vorë

Në periudhën Nëntor 2016- Nëntor 2017 rezulton se këshilli bashkiak Vorë ka marrë 110 vendime. Prej tyre 10 i përkasin periudhës Nëntor-Dhjetor 2016⁷². Për vitin 2016 vargu indeksues i vendimeve mbyllet me numrin "100". Ndërkohë, 56 VKB janë marrë në periudhën Janar-Shtator 2017⁷³. Të gjitha vendimet e marra gjatë periudhës që analizon ky raport janë gjithashtu të shfletueshme në Platformën Kombëtare VENDIME.AL, në faqen e dedikuar Bashkisë Vorë⁷⁴.

Në mbledhjen e datës 30 Nëntor 2016, Këshilli Bashkiak Kamëz ka marrë vendimin Nr. 97, dt. 30.11.2016 "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në buxhetin e bashkisë vorë për vitin 2016"⁷⁵. Nuk rezulton që Këshilli Bashkiak të ketë thirrur dhe të ketë organizuar vetë dëgjese për këtë vendimarrje. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak është aktori i vetëm i legjitimuar për të ndërmarrë konsultime mbi buxhetin, të cilat, në interpretimet ligjore të ekspertëve të INFOÇIP gjithashtu i nënshtrohen konsultimit (shih parashtrimet më sipër). Vetë Buxheti për vitin 2016 është miratuar në shkurt 2016⁷⁶. Edhe buxheti afatmesëm, 2017 dhe 2018 është miratuar përsëri në muajin Shkurt 2017, konkretisht në mbledhjen e datës 23.02.2017⁷⁷. Procesi konsultativ në Vorë nuk ndërmerret nga këshilli. Megjithatë, administrata përgjegjëse e bashkisë (drejtoria ekonomike dhe e financave) rezulton se ka marrë konsultime me aktorë interesi për hartimin e buxhetit. Në konsultim kanë prezent edhe përfaqësues nga shoqëria civile (Bordi Rinor Këshillimor).

Projekt-buxheti afatmesëm 2017-2019 ka qenë gjithsesi i afishuar në faqen zyrtare të bashkisë Vorë para miratimit të tij, bashkë me relacionin shoqërues. Titulli i vendimit gjithësi nuk reflekton siç duhet përmbajtjen e vendimit. Titulli është formuluar: "Mbi Miratimin e disa Ndryshimeve në Buxhetin e Bashkisë Vorë për vitin 2017-2019". Sa i takon vendimarrjes për Buxhetin e bashkisë 2017, ajo kam pësuar ndryshime në mbledhjen e datës 26 Prill 2017⁷⁸.

Në të njëjtën mbledhje është marrë vendim edhe për shtimin e numrit të punonjësve të bashkisë, që është si rregull një vendimarrje që i bashkalidhet buxhetit vjetor⁷⁹. Një tjetër shtesë punonjësish është bërë edhe në mbledhjen pas-ardhëse të datës 21 Mars 2017 ndërkohë që në mbledhjen e muajit Prill 2017 është bërë sërish ndryshim i nivelit të pagave për vitin 2017⁸⁰. Një tjetër ndryshim i nivelit të pagave është bërë në mbledhjen e KB të datës 25 Maj, 2017⁸¹.

72. <http://www.vendime.al/category/vore/2016-vore/>

73. <http://www.vendime.al/category/vore/2017-vore/>

74. <http://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-vore/>

75. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr97-date-30-11-2016/>

76. Vendimit të Keshillit Bashkiak nr.52 date 11.02 -2016" Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vorë për vitin 2016.

77. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr10-date-23-02-2017/>

78. <http://www.vendime.al/ep-content/uploads/2017/08/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr.21-dt.26.04.2017.pdf>

79. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr11-date-23-02-2017/>

80. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr22-date-26-04-2017/>

81. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr27-date-25-05-2017/>

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vorë të datës 21 Qershor 2017, është marrë vendim për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vorë për Vitin 2018-2020⁸². Nuk rezulton as në këtë rast që këshillit të këtë aktivizuar ndonjë protokoll konsultimesh. Në të njëjtën mbledhje janë miratuar edhe ndryshime për buxhetin e vitit të bashkisë Vorë për vitin 2017⁸³.

Nga vlerësimi konstatohet që vendimarrja buxhetore në bashkinë Vorë ka një incidencë të rritur, krahasuar me vendimarrjen e tjera. Ajo zë vendin e dytë në tipologjinë vendimarrëse për periushën e marrë në shqyrtim pas VKB për dhënien e ndihmës ekonomike dhe mbështetjes financiare për familjet në nevojë (42 të tilla për periudhën Nëntor 2016- Nëntor 2017). Në total janë 8 vendimarrje buxhetore dhe ndryshime që lidhen me të dhprojekte/se nivelin e pagave të punonjësve gjatë të njëjtës periudhë.

Ligji 139/2015 parashikon që seancat e këshillimeve me komunitetin janë të detyrueshme për këshillin bashkiak përpara shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit dhe ndryshimeve të tij (shih: neni 54, germa "dh" dhe neni 18/1). Nga monitorimi nuk rezulton që në rastin konkret të jenë thirrur konsultime nga këshilli bashkiak, si për miratimin ashtu edhe për ndryshimin e vendimarrjes për buxhetin 2017. Funksione të reduktuara konsultative janë ndërmarrë nga administrata e bashkisë, kryesisht në kuptimin e ekspozimit public të projekt-buxheteve.

Ndryshe nga bashkia Kamëz, nuk rezulton që në rastin e bashkisë Vorë, Prefekti i qarkut Tiranë të ketë kthyer akte për rishqyrtin në Këshillin Bashkiak.

Nuk rezulton që media të ketë raportuar mbi ndonjë proces konsultativ për Paketën Fiskale⁸⁴. Në fakt interesi mediatik për bashkinë Vorë ka qenë i ulët, në kontrast të thellë me interesin elektoral që kjo bashkia ka përfaqësuar gjithmonë. Në këtë bashki për më tepër janë të përqëndruara një numër i konsiderueshmë biznesesh, të cilat kanë një interes të natyrshëm të marrin pjesë në diskutimet për taksat dhe tarifatat vjetore. Nga ana tjetër, Bashkia Vorë ka një specifikë shumë interesante pasi ka treguesh shumë të kënaqshëm në realizimin e planit të ardhurave. Ky është një tregues që tarifatat vendore janë gjithsesi të vetë-përmbajtura dhe me gjasë edhe të drejta dhe racionale.

Të tjera ndryshime u bënë mbi Paketën Fiskale edhe në mbledhjen e datës 17 shkurt 2017 me anë të VKB 22⁸⁵ si edhe në mbledhjen e 20 Marsit 2017⁸⁶. VKB nr. 22/2017 gjithashtu u kthye nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe u ri-fut për miratim pa ndryshime në mbledhjen e datës 20 Mars 2017⁸⁷. Pakëta Fiskale i është nënshtruar ndryshimeve edhe përmes vendimeve nr. 53⁸⁸ dhe 54 gjatë vitit 2017⁸⁹ dhe në të gjitha rastet prefekti I ka kthyer këto VKB për vendimarrje në këshill. Në të gjitha rastet vendimet kanë kaluar pa ndryshime në mbledhjet e muajve pasardhës.

Ligji 139/2015 parashikon detyrimin e këshillit bashkiak për të thërritur konsultime vetëm kur ky i fundit vendos për taksat e tarifatat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi (neni 54, germa "f") dhe jo domosdoshmërisht kur miraton edhe ndryshimet e saj.

82. TE BASHKISË VORË PËR VITIN 2018-2020'

83. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr-34-date-21-06-2017/>

84. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr-20-date-26-04-2017/>

85. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr22-date-17-02-2017/>

86. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr42-date-20-03-2017/>

87. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr45-date-20-03-2017/>

88. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr53-date-24-04-2017/>

89. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr54-date-24-04-2017/>

Nga monitorimi rezulton që Këshilli Bashkiak Vorë të këtë marrë 1 VKM⁹⁰, të parashikuara nga nenin 54, germa "e" dhe konkretisht për tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Edhe në këto rast ligjvënësi ka parashikuar qartësisht se procesi konsultativ është i detyrueshëm me ligj dhe ndërmerret nga Këshilli Bashkiak (neni 18/1). Rezulton se në këshill janë zhvilluar konsultime direkt me palët që prekeshin nga kjo vendimarrje.

Çështje janë konstatuar në diskutimin e disa projekt-vendimeve në natyrë pronësore. Janë vënë re vështirësi në identifikimin e kompetencave ligjore lidhur mbi basenet ujore që janë në territorin administrativo - juridiksional të Bashkisë Vorë. Neni 9 i ligjit 139/2015 parashikon në paragrafin 1.2, pika b se (c) *e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër*. Në rastin e këshillit bashkiak Vorë konstohet një heqje arbitrare e kësaj kompetence të rëndësishme në rastin e tjetërsimit të pronësisë apo dhënies në përdorim të tretëve të këtyre baseneve.

Në nenin 22 të tij⁹¹, paragrafi 1 përcaktohet shprehimisht se (1.) *Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi*. Në nenin 23, "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" thuhet shprehimisht se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.

Sipas një interpretimi koherent të frymës së ligjit në këtë rast, basenet ujore në territorin e Bashkisë Vorë dhe destinacionet e tyre pronësore janë kompetencë vendimarrëse e Këshillit Bashkiak dhe nga monitorimi rezulton se kjo kompetencë është "tjetërsuar" padrejtësisht për këshillin bashkiak Vorë.



90. <http://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-vore-nr-38-date-21-06-2017/>

91. KREU VII FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, neni 22, Parimet për ushtrimin e funksioneve.

Organizimi dhe zhvillimi i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Mbledhjet e hapura

Këshilli Bashkiak Vorë, gjatë kohës që është realizuar ky monitorim, i ka akomoduar normalisht vëzhguesit e INFOÇIP. Në të paktën dy raste megjithatë, vëzhguesit e kanë aksesuar me vështirësi mbledhjen.

Salla e këshillit bashkiak Vorë ka pak hapësira fizike për të akomoduar/pranuar vëzhgues të pavarur apo publik të thjeshtë. Konfigurimi i sallës lejon që në rrjeshtin e fundit të mund të akomodohen jo më shumë se 7 veta.

Këshilli Bashkiak Vorë ka mbajtur një profil të ulët publik dhe mediatik. Kjo është një situatë tipike për këshillat e vegjel bashkiakë, ku konstatohet se solemniteti vendimarrës nuk e mbart dimensionin public (si në rastin e Tiranës psh). Mediat tradicionale në asnjë rast nuk kanë treguar interes për të përcjellë tek shikuesit e tyre mbledhjet e këshillit bashkiak të Vorës. INFOÇIP ka shfaqur vullnet për të realizuar transmetim live të mbledhjeve të këshillit bashkiak, por interesi nuk është vlerësuar nga anëtarët e këshillit, duke e pamundësuar në këtë mënyrë pilotimin e këtij dimensionit vendimarrës.



Njoftimi

Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes (neni 17, paragrafi 2).

INFOÇIP vetë ka marrë njoftim rregullisht mbi mbledhjet e Këshillit Bashkiak Vorë. Megjithatë sistemi i njoftimit përmes mënyrave/mjeteve të komunikimit masiv lë për të dëshiruar. Kontakti telefonik dhe email-i janë mjetet kryesore të përdorura për këtë qëllim. Në asnjë rast, nga monitorimi nuk është konstatuar që këshilltarët të kenë patur vërejtje për kohën dhe cilësinë e njoftimit të mbledhjeve të këshillit bashkiak.

Bashkia Vorë ka një help-desk modest, por shumë aktiv dhe eficient. Njoftimet për mbledhjet kanë qene pjesë e rutinës së dhënies së informacioneve të kërkuara. Megjithatë, nuk është konstatuar ndonjë praktikë alternative, sikurse do të ishte afishimi i njoftimeve në stendë apo përmes faqes zyrtare të internetit. Në këtë të fundit janë hedhur gjithsesi mjaft njoftime por prej tyre nuk identifikohet asnjë njoftim i cili të përkojë me dispozitat që përmban neni 17, paragrafi 2 i ligjit 139/2015. Në vitin 2017,

edhe publikimi i njoftimeve për media në faqen zyrtare të bashkisë nuk aplikohet më në faqen zyrtare të bashkisë. Në kushtet e kur kërkesat ligjore për transparencë sa vijnë e rritet, pritet që proceset vendimarrëse të jenë më prezente në dokumentacionin zyrtar që bashkia shpëndan përmes mjeteve të saj informimit.

Lidhur me njoftimin e mbledhjes, ligji 139/2015 përmban dispozita edhe në nenin 53⁹² të tij. Paragrafi 4 i këtij neni përcakton shprehimisht se: *Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj. Njoftimi përmban datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës.* Në një rast të tillë, përgjegjësia ligjore bie mbi sekretarin e këshillit bashkiak, i cili ka funksione të përcaktuara qartësisht në nenin 57/2 të ligjit 139/2015 sipas të cilit sekretari i këshillit bashkiak është përgjegjës ndër të tjera për: c) *njoftimin për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit.*

Nga vlerësimet e ekipit monitories të INFOÇIP rezulton se në çdo rast këshilltarët kanë marrë dijeni brenda afatit për datën e mbledhjes, orën, vendin dhe rendin e ditës nga sekretari i këshillit bashkiak. Konstatohet se në mbledhjet e këshillit bashkiak Vorë përgjithësisht nuk ka patur mungesa. Këshilli është kompakt dhe këshilltarët janë të dedikuar në ushtrimin e funksioneve të tyre vendimarrëse.

Nga monitorimi i praktikës vendimarrëse të këshillit bashkiak Vorë në periudhën Nëntor 2016-Nëntor 2017, nuk rezulton të këtë patur kërkesë nga 1/3 e këshilltarëve për të bërë mbledhje me dyer të mbyllura. Në këtë kuptim, parashikimet që përmban neni 17, paragrafi 3 nuk janë aktivizuar asnjëherë nga këshilli bashkiak Kamëz⁹³. Në të paktën një rast gjithsesi, ekipi monitorues i INFOÇIP është lutur që të largohet për të lejuar diskutimin e këshillimit lidhur me disa çështje infrastrukturore ku parashikoheshin shpronësime banesash.

Votimi

Konform përcaktimeve ligjore në fuqi, Këshilli Bashkiak Vorë ka 21 këshilltarë⁹⁴. Salla ku ata zhvillojnë mbledhjet e tyre është modeste dhe pa sisteme elektronike audio. Kuorumi i domosdoshëm për të deklaruar të hapura mbledhjet e këshillit bashkiak është 11 këshilltarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet një shumicë e cilësuar për marrjen e vendimeve (kur miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve). Nga monitorimi i realizuar rezulton se të gjitha mbledhjet që ka zhvilluar KB Vorë në periudhën Nëntor 2016- Nëntor 2017 janë hapur mbi kuorumin e domosdoshëm prej 11 anëtarësh. Përgjithësisht në mbledhjet e këshillit Bashkiak Vorë nuk ka mungesa. Shumicva e këshilltarëve i përkasin forcave të djathta politike. PS ka vetëm 3 këshilltarë të saj, kurse LSI ka 6.

Procesi i diskutimit në këshillin bashkiak Vorë është dinamik. Ai është menaxhuar me kompetencë dhe profesionalizën nga kryetarja e këshillit bashkiak, Znj. Vera Thana. Axhenda e mbledhjes dhe pikat shtesë të saj janë miratuar konform përcaktimeve ligjore që në fillim të mbledhjes pas marrjes së kuorumit nga sekretari i këshillit bashkiak.

Nuk janë venë re parregullsi në procedurën e votimit të projekt-vendimeve në përgjithësi. Komisionet e përhershme të këshillit janë lejuar rregullisht, konform parashikimeve ligjore në fuqi të ofrojnë shpejgime për projekt-aktet para miratimit të tyre.


92. Neni 53 "Funksionimi i këshillit bashkiak"

93. Në procesin e konsultimit legjislativ në komisionin parlamentar të ligjeve për projekt-ligjin 139/2015, INFOÇIP ka depozituar zyrtarisht amendament për abrogimin tërësor të dispozitave që përmban neni 17, paragrafi 3.

94. Neni 46 "Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak" - 1. ... Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë;

Neni 55 ‘Votimet’ parashikon në pikën 1 të tij se *votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë*. Këshilli, me kërkesë të jo më pak se 1/3 të anëtarëve të tij, vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. *Votimi i buxhetit dhe i akteve të tjera financiare që kanë lidhje me të bëhet kurdoherë i hapur*.


Nga monitorimi rezulton se të gjithë vendimarrjet e realizuar në KB Vorë janë bërë me votim të hapur (periudha Nëntor 2016-Nëntor 2017). Nuk rezulton në asnjë rast që 1/3 e këshilltarëve të këtë depozituar kërkesë për votim të fshehtë. Rezulton se edhe buxheti është miratuar konform përcaktimit ligjor (pika “dh”, neni 55 referuar nga neni 53, pika 3) dhe po ashtu ndryshimet në Paketën Fiskale. Parashikime më të plota duhet të vendosen në tekstin e një rregulloreje të përditësuar, e cila të jenë në përputhshmëri me përcaktimet ligjore në fuqi dhe jo me ligje tashmë të shfuqizuara.



Publikimi i vendimeve

Njoftimi i vendimarrjes është faza përbyllëse e procesit vendimarrës. Njoftimi është procesi përmes të cilit vendimarrja e këshillit bashkiak merr forcë ligjore.

Në kapitullin VI të ligjit 139/2015 dhe konkretisht në nenin 18 të tij⁹⁵, thuhet shprehimisht se “*Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim*”.



Vendimet e këshillit bashkiak Vorë janë të publikuara me rregullsi përmes ndërveprimit me Platformën Kombëtare VENDIME.AL. Në fillim të monitorimit, procesi nuk realizohej në mënyrë autonome nga vetë bashkia, për shkak të aksesit të kompromentuar në faqen që I është bërë dhuruar nga një program ndërkombëtar që punon në fushën e qeverisjes vendore. Brenda në faqen zyrtare, ka një rubrikë të dedikuar për buxhetin 2016-2018

95. “Seancat e këshillimeve me bashkësinë”

Hyrja në fuqi e vendimeve

Në pikën 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 përcaktohet shprehimisht se *"Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to"*.

Nga monitorimi rezulton se respektimi i këtyre afateve është sporadik. Shkaku kryesor në këtë rast ka të bëjë me mos-përcaktimin e modaliteteve të procedurës së shpalljes në ligj si dhe me afatet e konfirmimit të ligjshmërisë nga prefekti. Kjo përbën një vështirësi të lartë sa i takon matjes dhe vlerësimit të kohës fizike se inicimit të njoftimit dhe marrjes së subjektit dijeni për të. (Shih shpjegimet e detajuara teorike në rastin e Bashkisë Tiranë për këtë problematikë ligjore).



[Home](#)
[Rrethi vendime.al](#)
[Legjislatiori Vendor](#)
[Harta me 61 Bashki](#)
[Foto](#)
[Lajme](#)
[Kontakt](#)



VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK VORE nr.56 DATE 25.09.2017

By INFOÇIP On 03/11/2017 - Add Comment - In 2017, VORE VENDIME TE KESHILLIT BASHKIAK

MBI Miratimin e Lejes per ushtrim veprimtarie tej kohes normale "nonstop " jo me shume se nje vit

[Shkarkoje të plotë në PDF...](#)



VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK VORE nr.55 DATE 25.09.2017

By INFOÇIP On 03/11/2017 - Add Comment - In 2017, VORE VENDIME TE KESHILLIT BASHKIAK

MBI Miratimin e Listes se kerkesave per tu pajisur me AMPT duke iu referuar VKM nr.337.

[Shkarkoje të plotë në PDF...](#)



VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK VORE nr.54 DATE 25.09.2017

By INFOÇIP On 03/11/2017 - Add Comment - In 2017, VORE VENDIME TE KESHILLIT BASHKIAK

MBI Miratimin e dhenies ndihmes financiare familjes te znj.Naime Subashi.

[Shkarkoje të plotë në PDF...](#)



VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK VORE nr.53 DATE 25.09.2017

By INFOÇIP On 03/11/2017 - Add Comment - In 2017, VORE VENDIME TE KESHILLIT BASHKIAK

MBI dhenie ndihme financiare

[Shkarkoje të plotë në PDF...](#)



VENDIM I KESHILLIT BASHKIAK VORE nr.52 DATE 25.09.2017


By INFOÇIP On 03/11/2017 - Add Comment - In 2017, VORE VENDIME TE KESHILLIT BASHKIAK

MBI dhenie ndihme ekonomike per personat me hemodialize kimioterapi dhe komunitet te

MOTORI KRYESOR I KERKIMIT

KERKO VENDIMET SIPAS BASHKIVE NE HARTE





Përmbledhje e gjetjeve kryesore të studimit

Nga monitorimi i realizuar në të treja bashkitë, Tiranë, Kamëz Vorë rezulton se këshillat bashkiakë të konstituuar pas zgjedhjeve vendore të Majit 2015 nuk kanë adoptuar ende rregulloret e reja të këshillave sipas kërkesave të ligjit 139/2015. Funksionimi i tyre i brendshëm realizohet akoma sipas parashikimeve që përmbajnë rregulloret e vjetra, të adoptuara konform dispozitave të ligjit tashmë të shfuqizuar 8652 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Rekomandohet adoptimi sa më parë i rregulloreve të reja, konform dispozitave të ligjit 139/2015.

Këshillat bashkiakë nuk kanë mundur të ushtrojnë funksionet e tyre konsultative që ka parashikuar qartësisht ligji 139/2015. Funksionet konsultative janë “adoptuar” dhe në një pjesë të vendimmarrjes janë realizuar në mënyrë ekstra-ligjore nga administrata e bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.

Praktika e buxhetimit me pjesëmarrje, e udhëhequr nga krerët e ekzekutivit të bashkive ka vijuar të përdoret si ende metodë, edhe pse në ligj mungonë plotësisht parashikimet që e legjitimojnë një praktikë të tillë. Buxhetimi me pjesëmarrje nuk duhet të absorbojë buxhetimin e konsultuar, një praktikë konsultative e udhëhequr kjo nga këshilli bashkiak, konform përcaktive ligjore në fuqi.

Miratimi i ndryshimeve në buxhet nuk rezulton t’i jetë i nënshtruar në asnjë rast konsultimeve qofshin këto ligjore të ndërmarra nga këshillat bashkiakë, apo edhe ekstra-ligjore të realizuar nga ekzekutivi i bashkive. Ligji 139/2015 parashikon që seancat e këshillimeve me komunitetin janë të detyrueshme për këshillin bashkiak *përpara shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit dhe ndryshimeve të tij* (shih: neni 54, gërma “dh” dhe neni 18/1).


Në asnjë rast të monitoruar, nuk është konstatuar proces konsultativ (as nga këshilli që e ka detyrë funksionale, por as nga krerët e ekzekutivit, në rastet kur kjo konsiderohet si një nevojë praktike sikurse veprohet me raste për buxhetet) për rastet e parashikuara nga neni 18 paragrafi 1 kur referon nenin 54, gërma “e” lidhur me tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

Mbledhjet e këshillave bashkiakë janë përgjithësisht të hapura. Këshilli Bashkiak Tiranë i transmeton mbledhjet e veta live në televizione, ndërsa bashkia Kamëz ka bërë transmetim në live stream të mbledhjeve kryesore ku ka kaluar buxhetin. Bashkia Vorë, ndoshta për nga vetë specifika e saj, ka një vendimarrje të hapur, por gjithsesi pa dimension të shtuar mediatik. Sa i takon mbledhjeve të hapura dhe procesit vendimarrës në seance pleanare, këshillat bashkiakë kanë adoptuar deri më tani standarte të mira, por më shumë duhet bërë për të aksesuar komunitetin pa e ngarkuar me detyrimin për të marrë leje paraprakisht në organet e bashkisë apo të vetë këshillit.


Për rastet e parashikuara nga nenin 54, gërma "e" lidhur me tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve", ligji 139/2015 parashikon shumicë të cilësuar të këshilltarëve në momentin e votimit të projekt-aktit. Nga ana tjetër janë të paqarta cilësimet juridike se kush konsiderohen palë të treta. Paqartësia juridike në këtë rast ka ushqyer një debat politik dhe juridik lidhur me kuorumin e domosdoshëm në disa vendimarrje të këshillit bashkiak Tiranë.

Lidhur me vendimarrjet e parashikuara nga nenin 54, gërma "e" lidhur me tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve", ligji 139/2015 parashikon konsultimin e detyrueshëm të thirrur nga këshilli bashkiak. Një praktikë e tij nuk është vënë re në praktikë, dhe rekomandohet normimi i saj në rregulloret e reja të këshillave bashkiakë. Këshillat bashkiakë kanë funksione të shtuara konsultative në tërësi në parashikimet e reja që përmban ligji 139/2015. Këto funksione gjithsesi kanë mbetur të suprimuara dhe/ose të pa-aktivizuar deri më sot. Protokoli konsultativ duhet të rikuperohet i gjithë nga këshilli, si e vetmja praktikë e njohur dhe e detajuar ligjërisht në RSH.


Këshillat bashkiak duhet të ri-marrin dhe të interpretojnë ligjerisht funksionet shumë të rëndësishme që ligji 139/2015 iu ngarkon përveç ligjvënies vendore, dhe konkretisht harmonizimin e vendimarrjes përmes konsultimit dhe më pas edhe funksionet e kontrollit ndaj administratës së bashkisë. Afatet ligjore të hyrjes në fuqi të vendimeve të këshillave bashkiakë janë në përgjithësi të pa-respektuara dhe procedura formale e shpalljes së tyre është jo-rigoroze në terma të përcaktimit ligjor, harmonizimit me ligjin për prefektin dhe parimet e prezumimit të njoftimit të aktit zyrtar. Niveli i zbatimit të neneve që përmban Kreu VI i ligjit 139/2015 paraqitet si më poshtë, pas testimit të zbatueshmërisë së tyre në tre bashkitë e sipër-përmendura:



Zbatueshmeria vs Moszbatueshmeria



Zbatueshmëria e krahasuar e neneve të kreut 6



neni	Tirane	Kamez	Vore
15	85%	85%	85%
16	44%	44%	40%
17	68%	50%	36%
18	38.50%	38.50%	35%
19	100%	100%	95%
20	0%	35%	0%

Çështje mbi harmonizimin e legjislacionit

Ligji 139/2015 nuk është i harmonizuar me Kushtetutën e vendit, ose më mirë kjo e fundit nuk ka mundur akoma të gjejë harmonizimin e duhur me kuadrin e ri ligjor për qeverisjen vendore në Shqipëri, pas aktivizimit të ndarjes së re administrative-territoriale. Konkretisht, në nenin Neni 108, paragrafi 1 thuhet shprehimisht se "Njësitë e qeverisjes vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet". Edhe pse kushtetuta i është nënshtruar dy herë ndryshimeve pas miratimit të ligjit 139/2015, ligjvënësi e ka lënë të paflektuar situatën e re të krijuar në nivel të ndarjes administrative dhe në fushën e organizimit të ri të qeverisjes vendore në vetëm 61 bashki. Në rastin më të keq, një subjekt i legjitimuar mund të kërkonte një interpretim në Gjykatën Kushtetuese nëse legjislacioni i ri për ndarjen administrative apo për vetë qeverisjen vendore është apo jo në përputhje me parashikimet kushtetuese në fuqi.

Një tjetër kontradiktë që konstatohet është njohja dhe afirmimi i të drejtës për referendum vendor në nenin 18 të ligjit 139/2015 në një kohë që Shqipëria nuk ka patur dhe nuk ka aktualisht një kuadër ligjor për referendume, përfshi këtu ato vendore dhe ato të përgjithshme. Konform nenit 150, paragrafi 3 të Kushtetutës *Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj.*

Një kontradiktë tjetër verifikohet në këtë rast në terma të teknikës legjislative, pasi referendumi vendor është vendosur pikërisht në nenin ku bëhen parashikime për konsultimin buxhetor. Referendumi për buxhetin në çdo rast është i ndaluar nga Kushtetuta Republikën e Shqipërisë. Konform nenit 108/4 të Kushtetutës "Vetëqeverisja në njësitë vendore ushtrohet nëpërmjet organeve të tyre përfaqësuese dhe referendumeve vendore. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit vendor parashikohen me ligj në përputhje edhe me nenin 151 paragrafi 2". Nëse shohim këtë të fundit, "Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në asnjë referendum". Kjo i bën parashikimet që përmban ligji 139/2015 deri diku fiktive dhe jo-realiste në fazën e tanishme.

Në përgjithësi, çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e drejtpërdrejtë të demokracisë vendore janë të pamunduar aktualisht. Ligji 139/2015 ka bërë një përpjekje në drejtim të afirmimit të parimeve, por ai nuk ka realizuar dot detajimin e këtyre garancive.

Edhe neni 20⁹⁶ i ligjit 139/2015, i cili afirmon të drejtën e iniciativës qytetare është aktualisht i pazbatueshëm. Sipas këtij neni, Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. Së pari, sa kohë që në shumicën dërrmuese të tyre, këshillat bashkiakë nuk kanë adoptuar rregulloret e reja, e bën këto dispozita të pazbatueshme. Iniciativa qytetare të njihet si një nga format e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit, parashikuar në nenin 2 të Kushtetutës së Shqipërisë. Aktualisht shqipëri nuk ka një ligj për nismën ligjore qytetare, i cili do të përmbante rregullime matëriale dhe procedural për këtë qëllim. Është e kuptueshme që as këshilli bashkiak dhe as KQZ në një rast tjetër, nuk do ta lehtësonin dot këtë proces, sidomos kur parashikohet mbledhja dhe validimi i firmave.

96. parashikim që përmban kapitulli VI I ligjit 139/2015 dhe konkretisht neni 20

Lidhur me njoftimin, ligji 139/2015 gjithashtu "konsumon" më tepër nene sa sa është e nevojshme. Në pikën 6 të nenit 55 përcaktohet shprehimisht se *"Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to"*.

Një tjetër përcaktim që ka të bëjë me këtë fazë të procesit vendimarrës gjendet edhe në kapitullin VI të ligjit 139/2015 dhe konkretisht në nenin 18 të tij, i cili mban titullin "Seancat e këshillimeve me bashkësinë". Konkretisht në paragrafin 3 të këtij neni thuhet shprehimisht se *"Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim"*.

Do të ishte mirë nëse ky proces kaq i rëndësishëm, siç është njoftimi i vendimarrjes, të përmbledhej dhe normohej në një nen të vetëm dhe jo të shpërndahej apo amalgamohej, sipas rastit, në nene jo dhe aq relevante. Megjithatë në kuadër të metodologjisë që do të përdoret për këtë vlerësim, dispozitat përkatëse do të ri-grupohen për efekt të koherencës metodologjike.

Janë vënë re raste të konfliktit ligjor midis dispozitave që përman ligji 139/2015 dhe dispozitave që përmban Kodi Zgjedhor i RSH, i ndryshuar, dhe konkretisht në rastin e miratimit të marrjes së mandateve të këshilltarëve të rinj. INFOÇIP konsideron se dispozitat ligjore që përmban ligji 139/2015 duhen ri-parë në këtë drejtim. Konstatohet se ka një përplasje mes kompetencave të KQZ i cili, konform misionit të tij kushtetues dhe ligjor jep de-jure dhe de-facto mandatet e këshilltarëve dhe rolit të këshillit i cili duhet të administrojë mandatet e reja në kushte të pafavorshme numerike. Ligji 139/2015 i ka veshur këshillit bashkiak attribute të ekzagjeruara në raport me vendimarrjen për mandatet e reja të këshilltarëve zëvendësues duke shtënë në kontradiktë vullnetin e shprehur përmes votës popullore (marrja e mandateve përmes KQZ që administron numërimin e votës dhe ndarjen e mandateve sipas rezultateve të votimit) me vullnetet politike në këshillin bashkiak të përfaqësuesve lokalë. Kjo kontradiktë duket se ka kompromentuar zhvillimin normal të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 26 Korrik 2017, duke degjeneruar procesin deri në konflikt gjyqësor. Në terma konkretë: paragrafi 1 i nenit 49 të ligjit 139/2015 sipas të cilit "Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak" bie në kontradiktë me parashikimet që përmban Kodi Zgjedhor, i ndryshuar (neni 164⁹⁷). Kjo kontradiktë theksohet më tej në parashikimet që përmban neni 45⁹⁸ i ligjit 139/2015 sipas të cilit, *Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë*.

Rekomandohet që njohja e kushteve të papajtueshmërisë të mandatit të këshilltarit dhe dhënie e mandateve të reja të mos i nënshtrohet procesit të votimit në këshillin bashkiak. Harmonizimi i dispozitave ligjore që normojnë këtë proces mund dhe duhet të adresohet përmes interpretimit të Gjykatës Kushtetuese dhe/ose përmes amendimit të dispozitave që përmban ligji 139/2015 lidhur me mënyrën e votimit të dhënies dhe heqjes së mandateve të reja gjatë kohës që këshilli është i mbledhur në mandat të rregullt legjislativ vendor.

97. Neni 164 "Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancës", paragrafi 2: Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

98. Neni 45 "Mënyra e zgjedhjes", http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/249.pdf

Çështje janë konstatuar në diskutimin e disa projekt-vendimeve në natyrë pronësore. Janë vënë re vështirësi në identifikimin kompetencave ligjore lidhur mbi basenet ujore që janë në territorin administrativo - juridiksional të Bashkisë Vorë.

Neni 9 i ligjit 139/2015 parashikon në paragrafin 1.2, pika b se (c) e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli përkatës, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër. Në rastin e këshillit bashkiak Vorë konstatohet një heqje arbitrare e kësaj kompetence të rëndësishme në rastin e tjetërsimit të këtyre baseneve. Po ashtu, në nenin 22 të tij⁹⁹, paragrafi 1 përcaktohet shprehimisht se (1.) Njësitë e vetëqeverisjes vendore rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe ligjet në fuqi. Në nenin 23, "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike" thuhet shprehimisht se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm. 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara. Legjislacioni për ujrat dhe basenet ujore duhet të vijojë të harmonizohet me parashikimet që përmban ligji 139/2015 dhe këshilli duhet të ushtrojë kompetenca të plotë për çështje që kanë të bëjnë me tjetërsimin e pronësisë/dhënies në përdorim të tyre tek të tretë. Po ashtu mbeten të paqarta detyrimet e këshillit bashkiak në rastet kur ky i fundit merr vendime për transferim/kalim të pronave midis inventareve të ndërmarrjeve të veta me kapital publik.

Shpallja e akteve është një tjetër element i cili kërkon parashikime rigoroze në ligjet përkatëse. Konkretisht, në ligjin 139/2015, në nenin 55, pika 6 përcaktohet shprehimisht se "Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to". Ndërkohë, në ligjin e ri "Për Prefektin e Qarkut", ligjvënësi ka parashikuar në nenin 16 se: a) çdo organ i njësisë së vetëqeverisjes vendore është i detyruar të depozitojë te prefekti i qarkut të gjitha aktet me karakter normativ, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së tyre...b) për çdo akt të regjistruar në zyrën e protokollit, prefekti i qarkut detyrohet të shprehet për ligjshmërinë e tij, brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit...". Është evidente se përcaktimet ligjore të afateve në dy ligje të ndryshme janë të paharmonizuara. Koha e hyrjes në fuqi të VKB normative nuk mund të fillojë gjatë kohës që prefekti verifikon ligjshmërinë e aktit.

Ligji 139/2015 ka parashikuar në nenin 8¹⁰⁰ të tij se "*organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërësave dhe urdhrave*". Një përcaktim të tillë, ligji 139/2015 e përmban dy herë, pasi edhe në nenin 9¹⁰¹ ai thekson shprehimisht se: "*bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave, nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra*".

Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj¹⁰². Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nuk definon kompetencën dhe nuk detajon karakterin e akteve me të cilat disponojnë degët e organit të qeverisjes vendore (këshilli vs. kryetari me administratën e tij). Mund

99. KREU VII "Funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore", neni 22, parimet për ushtrimin e funksioneve.

100. Neni 8, paragrafi 2. KREU III TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

101. Neni 9 "Të drejtat dhe përgjegjësitë", germa "b"

102. Neni 13 Mbikëqyrja dhe kontrolli, paragrafi 2 / ligji 139/2015



të merret me mend vetëm se vendimet janë kompetencë ekskluzive e këshillit bashkiak, në të njëjtën mënyrë sikurse ligjet janë kompetencë e Kuvendit (me analogji funksionale).

Edhe për urdhrat mund të thuhet se ato janë instrumenti juridik dhe administrativ me të cilat disponon kryetari i bashkisë, si titullari i degës ekzekutive të organit të qeverisjes vendore. Megjithatë ligji 139/2015 krijon një vështirësi (ose mbart paqartësi) në vlerësimin e kompetencës për të nxjerrë këtë loj akti, pasi në nenin 13 (përmendur më sipër) ai flet për "urdhra me karakter normativ" të cilat i nënshtrohen kontrollit të ligjshmërisë nga Prefekti/Gjykata. Në praktikën administrative, urdhri gjithmonë adreson një subjekt juridik/individual të së drejtës dhe rrjedhimisht ai ka karakter individual. Paqartësi të tilla duhet të adresoheshin përmes akteve nënligjore që në këtë rast do të duhej të nxirreshin nga Këshilli i Ministrave.

Sa i përket Urdhërësive, kompetenca për nxjerrjen e tyre mbetet gjithashtu e pasqaruar në ligj, edhe pse implikohet se ato janë instrumenta juridike të këshillit bashkiak. Konkretisht, në nenin 69 "*Detyrat dhe të drejtat e këshillit dhe ndërlidhësit komunitar*", gjendet ky përcaktim në paragrafin 4. "*Detyrat më të hollësishme të tyre përcaktohen në rregulloret dhe urdhëresat e këshillit bashkiak*"¹⁰³. Në praktikën e organeve të qeverisjes qëndrore, udhëzimet janë akte me natyrë normative të cilat nxirren në respekt dhe për zbatimin të ligjit nga titullari përkatës, kryesisht ministrat e qeverisë. Kjo praktikë është ndjekur me sa duket edhe në rastin e disa urdhërësive të nxjerra nga kryetari i bashkisë Tiranë¹⁰⁴ të cilat kanë qartazi natyrë normative (fuqi juridike rregulluese të përgjithshme). Mbetet gjithsesi që të qartësohet më mirë natyra dhe burimi i së drejtës për llojin e aktit "urdhëresë".

Në tërësinë e vete, Pushteti Vendor është i detyruar të ushtrojë veprimtarinë e vet në respekt të rreth 130 ligjeve të ndryshme që kanë pikëprerje me sektorin. Harmonizimi i veprimtarisë vet me kaq shumë ligj krijon një vështirësi reale për vendimarrjen e këshillave. Këta të fundit janë të asistuar pak ose aspak nga trupa profesionale të cilat do të duhet të harmonizoni paraprakisht vendimarrjen e tij me përcaktimet ligjore në fuqi. E vetmja përmbledhje legjislative e përditësuar në dispozicion të këshillave është hartuar nga INFOÇIP me mbështetjen e OPC dhe Leviz Albania dhe është linkuar në faqet respektive të bashkive partnere, përfshi Kamzën dhe Vorën. Ka ardhur koha që këshillat të kenë administratën e tyre të pavarur. Ky në fakt është një realitet në rastin e Këshillit Bashkiak Tiranë, por duhet të replikohet edhe për këshillat e tjerë, të cilët administratë të vetme kanë sekretarët e këshillave.

Precedent i nismës ligjore qytetare i Kamzës (shih më sipër të trajtuar hollësisht) është një test me rezultat negativ për aktivizimin efikas të parashikimeve që përmban neni 20 i ligjit 139/2015. Vetë neni është i konceptuar mbi një marrdhënie *sender-receiver*, e cila është një praktikë e pazakontë në teknikën e shkrimit legjislativ. Rekomandohet që ky nen të pasurohet më tej dhe të mundësojë efektivisht marrjen e iniciativave ligjvënëse qytetare. Po ashtu rekomandohet që të drejtat dhe përgjegjësitë e këshillit dhe ato të iniciuesve të parashikohen në nene të ndryshme, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të jenë efektivisht dhe objektivisht të matshme dhe të vlerësueshme në terma të zbatueshmërisë. Rekomandohet që në nismën ligjvënëse për iniciativën qytetare të adoptohen parashikime rigoroze procedural për nismat në nivel vendor dhe të urdhërohet harmonizimi i rregulloreve të këshillave bashkike me normativën ligjore në fuqi.

103. I njëjti forulum haset edhe në pikën 3, Neni 71 "Detyrat dhe të drejtat e kryetarit dhe të kryesisë së fshatit"

104. <http://www.tirana.al/tirana-legjislacion/akte-te-kryetarit/>

Vlerësimi Metodologjik

Nr. dhe titulli i nenit	Paragrafet e nenit	E matshme/kuatifikueshme/ jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike në vlerësim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhene ose e konstatuar nga grupi monitorues		
					Tirane	Kamez	Vore
Neni 15 Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore	1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre	Jo e matshme (Është afirmim i parimit të pergjithshem)					
			Publikim në faqe të vendimeve Pesha specifike në vlerësimin e paragrafit (PSVP) 50%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	
	2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësive vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.	E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmerisë së nenit: 50%	Publikim në faqe i urdhërësive PSVP 20%	Po (100%) Jo (0 %) Tjeter (100%)	Po	Tjeter	Tjeter
			Publikim në faqe i urdhërave PSVP 20%	Po (100%) Jo (0 %)	Jo	Jo	Jo
Rezultatet e zbatueshmerise se nenit ne teresi : 85%							
Total i akumuluar per secilen bashki:							
	Tirane	Kamez	Vore				
	85%	85%	85%				

			Afshim në stendë PSVP 10%	Po (100%) Jo (0 %)	Jo	Jo	Jo
			Caktimi i koordinorit të DI PSVP 20%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Miratimi i Programit të Transparencës PSVP 20%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Akses ne faqe- Faqe interneti e perditësuar PSVP 10%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Akses - Help desk/prije popullit PSVP 10%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Përgjigje e kërkesave në kohë PSVP 10%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Dispozita të LDI të tjera: hartim-publikim-përditësim regjistri PSVP 20 %	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po

Nr dhe titull neni	Paragrafet e nenet	E matshme/kuatifikueshme/ jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike ne vleresim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhene ose e konstatuar nga grupi monitorues							
					Tirane	Kamez	Vore					
Neni 16 Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore Rezultatet e zbatueshmerise se nenet ne teresi : 42.6 % Total i akumuluar per secilen bashki: <table><tr><td>Tirane</td><td>Kamez</td><td>Vore</td></tr><tr><td>44%</td><td>44%</td><td>40%</td></tr></table>	Tirane	Kamez	Vore	44%	44%	40%	1. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes	E matshme Pesha specifike ne vleresimin e zbatueshmerise se nenet: 80%	Njoftimi per konsultim publik nga autoriteti vendimarrës (PSVP) 25%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjehere	Asnjehere
	Tirane	Kamez	Vore									
	44%	44%	40%									
	Procervebali per konsultimin publik (PSVP) 25%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjehere	Asnjehere								
	Njoftimi per mbledhjet (PSVP) 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Disa here	Disa here	Disa here							
Njoftimi ne afat per mbledhjet (PSVP) 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Disa here	Disa here	Disa here								
Mbledhje te hapura vs. mbledhje te mbyllura (PSVP) 10%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Gjithmonë	Gjithmonë	Disa here								
	2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik	E matshme Pesha specifike ne vleresimin e zbatueshmerise se nenet: 20%	Caktimi i koordinatorit (PSVP) 100%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po					

Nr. dhe titulli i nenit	Paragrafet e nenit	E matshme/kua tifikueshme/ jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike ne vleresim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhene ose e konstatuar nga grupi monitorues		
					Tirane	Kamez	Vore
Neni 17 Mbledhjet e këshillit të bashkisë Rezultatet e zbatueshmerise se nenit ne teresi : 51.3% Total i akumuluar per secilen bashki Tirane Kamez Vore 68% 50% 36%	I. Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit	E matshme Pesha specifike ne vleresimin e zbatueshmeri se se nenit: 40%	Pjesëmarrja e qytetarëve në mbledhje (PSVP) 10%	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Disa here	Disa here	Disa here
			Pjesëmarrja e shoqërisë civile në mbledhje PSVP 10%	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Disa here	Disa here	Disa here
			Vende të posacme për vizitorët për tu ulur PSVP 10%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Po
			Gazetarë të pranishëm në mbledhje PSVP 10%	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Gjithmone	Asnjehere	Asnjehere

			Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Gjithmone	Disa here	Asnjehere
Transmetimi live me median locale, ose internet, faqe zyrtare, live strim, ose FB PSVP 10%	Dispozita të posacme në rregulloren e këshillit bashkiak, sipas frymës. Kërkesave të ligjit 139/2015 PSVP 50%	Mungese rregullore ose e papërditesuar Rregullore e përditësuar përparashikim (50 pikë) Mungesë rregullore ose e papërditësuar (0 pike)	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Mungese rregullore ose e papërditesuar	Disa here	Asnjehere
Njoftim në faqen zyrtare PSVP 20%	Njoftim në stenda PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Disa here	Asnjehere	Disa here
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën	E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit: 40%					

dhe rendin e ditës së mbledhjes.	Njoftim me media PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa herë (50%) Asnjëherë (0%)	Gjithmone	Asnjehere	Asnjehere
	Atributet e njoftimit, axhenda PSVP 40%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Po	Jo
3. Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij	E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmeri se se nenit: 20%	Prania e kërkesës së kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit Bashkiak PSVP 50%	Po (100%) Jo (0 %) Tjetër (100%)	Tjetër	Tjetër
	Votimi prej 3/5 PSVP 50%	Po (100%) Jo (0 %) Tjetër (100%)	Tjetër	Tjetër	Tjetër

Nr. dhe titulli i nenit	Paragrafet e nenit	E kuantifikueshmë / jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike në vlerësim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhënë ose e konstatuar nga grupi monitorues		
					Tirane	Kamez	Vore
Neni 18 Seancat e këshillimeve me bashkësinë Rezultatet e zbatueshmërisë së nenit në teresi :37.3% Total i akumuluar për secilin bashki: :	1. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për rastet e parashikuara në nenet 54, shkronjat "a", "dh", "e", "f" dhe "k"	E matshme Peshë specifike në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit :35%	Këshillim i thirrur nga këshilli për "a" Peshë specifike në vlerësimin e paragrafit (PSVP) 10% Këshillim i thirrur nga këshilli për "dh" PSVP 30%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%) Tjeter (100%) Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Tjeter (100%)	Tjeter (100%)	Asnjëherë (0%)
					Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)

Tirane	Kamez	Vore
38,5%	38,5%	35%

	Këshillim i thirrur nga këshilli për "e" PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)
	Këshillim i thirrur nga këshilli për "f" PSVP 30%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)
	Këshillim i thirrur nga këshilli për "k" PSVP 10%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%) Tjeter (100%)	Asnjëherë (0%)	Tjeter (100%)	Tjeter (100%)
	Caktimi/pasja e dispozitave në rregullore PSVP 20%	Rregullore e përditësuar me dispozita në frymën e ligjit të ti (100%) Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)	Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)	Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)	Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)
2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime	E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit: 30%				

Takime të hapura me banoret, të thirrura nga këshilli PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)
Takime me specialistë të thirrur nga këshilli PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)
Takime me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse PSVP 20%	Gjithmonë (100%) Disa here (50%) Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)	Asnjëherë (0%)
Referendum vendor PSVP 20%	Po/Jo/Tjeter	Jo	Jo	Jo
Aktet të pasqyruara në faqe PSVP 80%	Plotësisht (100%) Pjesërisht (50%) Asnjë (0%)	Plotësisht (100%)	Plotësisht (100%)	Plotësisht (100%)
Stendë PSVP 20%	Plotësisht (100%) Pjesërisht (50%) Asnjë (0%)	Pjesërisht (50%)	Pjesërisht (50%)	Asnjë (0%)
E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit 35%:				
3. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.				

Nr. dhe titulli i nenit	Paragrafet e nenit	E matshme /kuatifikueshme / jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike ne vleresim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhene ose e konstatuar nga grupi monitorues							
					Tirane	Kamez	Vore					
Neni 19 E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes Rezultatet e zbatueshmerise se nenit ne teresi : 98.3% Total i akumuluar: <table><tr><td>Tirane</td><td>Kamez</td><td>Vore</td></tr><tr><td>100%</td><td>100%</td><td>95%</td></tr></table>	Tirane	Kamez	Vore	100%	100%	95%	1. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.	E matshme Pesha specifike ne vleresimin e zbatueshmeris e se nenit: 50%	Ankesa/kërkesa të depozitura efektivisht Pesha specifike ne vleresimin e paragrafit (PSVP) 50%	Po (100%) Jo (0 %)	Po Po	Po Po
	Tirane	Kamez	Vore									
	100%	100%	95%									
				Formularë tip/sisteme kompjuterike PSVP 35%	Po (100%) Jo (0 %)	Po Po	Po Po					
			Asistencë teknike në sportel PSVP 30%	Po (100%) Jo (0 %)	Po Po	Po Po						

2. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.	E matshme	Sportelet e pritjes me popullin PSVP 40%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)
			Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)
			Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)
Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmërisë së nenit: 50%	Rubrika të posacme në faqet e internetit për administrim kërkesa ankesa PSVP 10%	Kthim përgjigje brenda afateve të parashikuara PSVP 50%	Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)
			Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)
			Po (100%) Jo (0 %)	Po	Gjithmonë (100%)

Nr. dhe titulli i nenit	Paragrafet e nenit	E matshme /kuatifikueshme / jo e matshme	Dispozita të matshme dhe pesha specifike në vlerësim	Shkalla kuantifikuese / mënyra e matjes	Vlera e dhene ose e konstatuar nga grupi monitorues		
					Tirane	Kamez	Vore
Neni 20 E drejta e iniciativës qytetare Rezultatet e zbatueshmerise se nenit ne teresi : 11.6% Total i akumuluar per secilen bashki	1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e	E matshme /kuatifikueshme / jo e matshme E matshme Peshë specifike në vlerësimin e zbatueshmeris e se nenit: 80%	Ushtrimi i te drejtes Peshë specifike në vlerësimin e paragrafit (PSVP) 35%	Po (100%) Jo (0%) Tjeter (0%)	Tjeter	Po	Tjeter
			Mundësimi i se drejtes Percaktimi i rregullave / procedurave në rregulloren e këshillit PSVP 35%		Rregullore e përditësuar në frymën e ligjit të ri (100%) Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)	Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)	Rregullore e përditësuar pa dispozita dhe/ose Rregullore e papërditësuar (0%)

Tirane	Kamez	Vore
0	35%	0%

organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.		Marrja parasysh e se drejtes PSVP 40%	Po (100%) Jo (0%) Tjeter (0%)	Tjeter	Jo	Tjeter
2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.	E matshme Pesha specifike në vlerësimin e zbatueshmeris e se nenit: 20%	Shqyrtim nga këshilli në rendin e ditës per Iniciativa të paraqitura PSVP 50%	Po (100%) Jo (50%) Tjeter (0%)	Tjeter	Tjeter	Tjeter
		Vlerësim me shkrim nga administrata/kryetari PSVP 50%	Po (100%) Jo (50%) Tjeter (0%)	Tjeter	Tjeter	Tjeter

